



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 58

19 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr. 269, datë 3.4.2013

Për miratimin e Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së
Mbrojtjes..... 2509

Vendim i KM
nr. 270, datë 3.4.2013

Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të
Kuvajtit për shërbimin ajror..... 2535

VENDIM
Nr. 269, datë 3.4.2013

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKIMIT TË STRATEGJISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RISHIKIMI STRATEGJIK I MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MARS 2013

Mesazh i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, z. Sali Berisha
Të nderuar bashkëqytetarë!

Dokumenti që keni në dorë, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, është një dokument i rëndësishëm së veçantë, veçanërisht për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, e më pastaj për ekspertët, planëzuesit dhe furnizuesit e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare.

Rishikimi strategjik i mbrojtjes përbën një qasje analitike bashkëkohore ndaj risqeve dhe rreziqeve të mjedisit të sigurisë kombëtare dhe rajonale, i cili duhet dhe do të trajtohet si një parakusht për kërkesa të mirëmenduara për kapacitetet e mbrojtjes sonë kombëtare, në një periudhë afatmesme, mbështetur dhe udhëhequr dhe nga parimet e konceptit strategjik të Lisbonës.

Ky rishikim strategjik i mbrojtjes sonë kombëtare vjen pas një periudhe të shkurtër por të ngjeshur me reforma integruese, qysh prej vitit 2009, viti i anëtarësimit në NATO. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij dokumenti do ta përshpejtojnë, duke e çuar drejt përmbylljes procesin e integritetit të Shqipërisë në NATO, pasi implementimi i këtyre rekomandimeve do të formësojë një forcë të armatosur efikase, të ndërveprueshme dhe mbi të gjitha një forcë të armatosur të aleancës, ku mbrojtja kolektive shkon krah mbrojtjes konvencionale, njëra duke plotësuar tjetrën.

Rekomandimet e rishikimit strategjik të mbrojtjes, hedhin kështu bazat për transformimin e Forcave të Armatosura në përputhje me rritjen e profesionalizmit dhe përmbushjen e standardeve më të përparuara të Aleancës.

Gjej rastin të përgëzoj dimensionin ndërinstitucional të procesit të rishikimit strategjik, gjë që përforcon besimin se mbrojtja dhe siguria kombëtare realizohet me bashkërendim mes strukturave përgjegjëse.

Sali Berisha



HYRJE

Të nderuar lexues!

Pas një periudhe pune e përpjekjesh prej 18 muajsh, ju paraqesim qytetarëve shqiptarë këtë dokument të rishikimit strategjik të mbrojtjes së Shqipërisë, i pari dokument i këtij lloji si vend aleat i NATO-s.

Ai u iniciua nga Kryeministri i Shqipërisë, u formulua nga ekupe të ekspertizës me të mirë kombëtare, dhe u mbështet në mënyrë koherente nga aleatet e NATO-s.

Rishikimi strategjik i mbrojtjes është një dokument për të gjithë, për: politikanët, qytetarët, ekspertët, ushtarakët, gazetarët, grupet e interesit dhe shoqërinë civile, përfshi komunitetin ndërkombëtar. Botimi i hapur për publikun i këtij dokumenti, përveçse respektimit të normave demokratike, përbën një shprehje të transparencës në fushën e mbrojtjes.

Rishikimi strategjik i mbrojtjes lindi si një domosdoshmëri për:

1. Adresimin e risqeve të reja të mjedisit të sigurisë në nivel kombëtar ballafaquar njëkohësisht me atë rajonal dhe global.

2. Krijimin, zhvillimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të kapaciteteve të mbrojtjes dhe sigurisë, kapacitete të cilat i shërbejnë sa vendit ashtu edhe aleancës ku aderojmë.

3. Ndërtimin e një force të armatosur efikase, të mirëpajisur dhe të mirëtrajnuar, në kushtet e kufizimeve financiare të parashikimeve makroekonomike afatmesme.

Nisur prej këtyre premisave, procesi i rishikimit strategjik të mbrojtjes, shërbeu në radhë të parë si një instrument analize racionale, dhe si një mjet planifikimi në terma sa më të përafërt me metodat më bashkëkohore të planifikimit të NATO-s.

Si i tillë, “ushtrimi” i RSM-së u përqendrua në përpjekjen për të arritur të një buxhetim i mirëbalancuar mes tre komponentëve: personelit, operacioneve e mirëmbajtjes dhe investimeve/modernizimit. Një buxhet i balancuar do të çojë, në terma afatmesëm, drejt një force të armatosur efikase në përmbushjen e misionit të saj kushtetues dhe detyrimeve ndaj mbrojtjes kolektive në kuadër të aleancës.

Rekomandimet që parashtrihen në këtë dokument kapacitetet e kërkuara, gatishmëria e pritshme dhe madhësia e Forcave të Armatosura, janë në përputhje të plotë me qëllimin fillestar të procesit për rritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura, duke i balancuar ato me nivelin e ambicies dhe burimet financiare.

Procesi i rishikimit i kaloi ndjeshëm përmasat e institucionit të mbrojtjes. Dhjetë institucione të tjera u përfaqësuan aktivisht gjatë tij. Më tej, ai u konsultua me aktorë të tjerë joqeveritarë e të shoqërisë civile.

Shpreh bindjen time, se ky rishikim u ka vlejtur të gjithëve si një praktikë e mirë e veprimit ndërinstitucional.

Falënderoj të gjitha institucionet pjesëmarrëse dhe individët që u përfshinë në këtë proces shumë të rëndësishëm për të ardhmen e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit tonë.

MINISTRI I MBROJTJES
Arben Imami

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RSM-SË

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes 2012 (RSM 2012) kryhet në kushtet kur Shqipëria është një vend aleat i Traktatit të Atlantikut të Veriut. Ai fillon me një vlerësim analitik të mjedisit aktual dhe të pritshëm të sigurisë dhe të mbrojtjes, vazhdon me identifikimin e interesave dhe të objektivave kombëtarë dhe më tej, me qëllim argumentimin analitik për rolin e Forcave të Armatosura në këtë

mjedis, sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që ato duhet të disponojnë, sipas skenarëve më të mundshëm të përdorimit të tyre, si dhe organizimin e tyre në një forcë moderne e të besueshme për përmbushjen e misionit kushtetues, në kuadrin e mbrojtjes kolektive apo më vete.

Kreu i parë, jep një panoramë të përgjithshme mbi arsyet, objektivin, përjasjet, konceptin, aktorët pjesëmarrës, dhe metodologjinë e ndjekur për kryerjen e tij. Vëmendje e veçantë i kushtohet organizimit të këtij procesi ndërinstitutional: nga faza e inicimit të tij deri në atë të gjetjeve, rekomandimeve dhe planeve mbështetëse e ndryshimeve ligjore të gjeneruara nga ky dokument strategjik.

Kreu i dytë, trajton interesat kombëtare të RSH-së, gjendjen aktuale dhe pritjet e mjedisit të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale. Ai vazhdon me rolin, misionet, detyrat dhe objektivat e FASH-it në mjedisin e sotëm dhe të ardhshëm të sigurisë, spektrin e operacioneve të tyre brenda dhe jashtë vendit, nivelin e ambicies, si dhe supozimet politike, ushtarake dhe ekonomiko-financiare të këtij RSM.

Kreu i tretë, përshkruan pritjet e zhvillimit ekonomik dhe financiar të vendit dhe resurset financiare të mundshme në dispozicion të mbrojtjes për të zhvilluar kapacitetet e kërkuara nga RSM në planin afatmesëm/afatgjatë. Kjo përjasje e RSM-së, ku kapacitetet kryesore operationale balancohen me pritjet financiare, hedh bazat e një planifikimi afatgjatë të mbrojtjes mbi baza realiste e më këmbë në tokë.

Kreu i katërt, si pasojë e ndryshimeve të mjedisit të sigurisë të shprehura në kreun e dytë, shqyrton skenarët përfaqësues strategjikë, ku mund të përfshihen FASH në periudhën afatmesme/afatgjatë, si dhe kapacitetet kryesore të saj për përballimin e tyre. Nëpërmjet metodës së krahasimit të disa alternativave, që konsideron si tepricat ashtu dhe boshllëqet ekzistuese të kapaciteteve, bëhet një përzgjedhje e balancuar e kapaciteteve prioritare të forcës së ardhshme për përmbushjen e misionit kushtetues. Ky kre jep, gjithashtu, konceptin e përdorimit të FASH-it në operacionet e saj së bashku me aleatët ose më vete.

Kreu i pestë, bazuar në përfundimet e kapitujve të mëparshëm, shpreh rekomandimet dhe gjetjet kryesore për zhvillimin e një force të armatosur të besueshme dhe të përballueshme financiarisht, efektive dhe të aftë për mbrojtjen e interesave kombëtare, përmbushjen e misioneve dhe të detyrave, sipas sfidave të mjedisit të sigurisë. Ai shoqërohet, gjithashtu, me drejtimet kryesore për zhvillimin e kapaciteteve të kërkuara në periudhën afatmesme.

KREU I

PROCESI I RISHIKIMIT STRATEGJIK TË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I.1 Arsyet e rishikimit strategjik të mbrojtjes

Arsyet e këtij rishikimi strategjik të mbrojtjes (RSM) së Republikës së Shqipërisë janë të shumta, por tri prej tyre janë më kryesoret:

1. Shqipëria është një vend anëtar i organizatës së Atlantikut të Veriut që prej vitit 2009. Kalimi nga sistemi i sigurisë dhe i mbrojtjes individuale në atë kolektive përbën një ndryshim thelbësor në konceptin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, me ndikimet përkatëse në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse.

2. Shqipëria ndodhet në një mjedis të sigurisë rajonale në ndryshim të shpejtë e dinamik. Shumë qëndrime në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së Shqipërisë kanë nevojë të aktualizohen si pasojë e ndryshimeve të ndjeshme të mjedisit të sigurisë të viteve të fundit dhe në përputhje me sfidat e pritshme të mjedisit të sigurisë në zhvillim.

3. Shqipëria do të harmonizojë shpenzimet e mbrojtjes me zhvillimet e sotme dhe ato të pritshme ekonomike e financiare të vendit. Ajo do të orientohet drejt një mbrojtje racionale nën një ballafaqim realist me treguesit makroekonomikë dhe financiarë të vendit.



I.2 Objektivi i RSM-së

Bazuar në arsyet e mësipërme, ky RSM u ofron Shqipërisë dhe shqiptarëve një zgjidhje realiste dhe në balancë të arritshme mes objektivave dhe burimeve në dispozicion për mbrojtjen e vendit.

Objektivi fundor i RSM-së është ndërtimi i një force të armatosur efikase dhe të përballueshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe garantimin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit tonë në përputhje me zhvillimet e mjedisit të sigurisë, realitetin e anëtarësimit në aleancë dhe mundësitë e burimet e vendit.

Ky rishikim është një proces që do të gjenerojë një numër reformash transformuese në sistemin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit. Ai përcakton rolin, vendin, kapacitetet dhe mbështetjen me burime të Forcave të Armatosura të RSH-së në perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme.

I.3 Organizimi dhe aktorët e procesit të RSM-së

Rishikimi strategjik i mbrojtjes është një proces ciklik në nivelin strategjik. Ai u iniciua në shkurt 2011 nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, bazuar në një analizë racionale të interesave dhe objektivave kombëtarë, zhvillimeve të mjedisit të sigurisë, përfitimeve dhe detyrimeve nga sistemi i sigurisë dhe i mbrojtjes kolektive, si dhe zhvillimit ekonomik e financiar të vendit.

Procesi i RSM-së u organizua si një proces kombëtar ndër-institucional me pjesëmarrjen e dhjetë institucioneve që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e RSH-së¹. Krahas objektivit për të ndërtuar një forcë të armatosur të aftë për të përmbushur misionin e saj, kjo përjasje gjithëpërfshirëse formësoi një klimë bashkëpunimi për zhvillimin e koordinuar të kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë kombëtare, duke evituar kapacitetet paralele, të panevojshme, apo që u ka kaluar koha.

Në një fazë të pjekur të procesit të RSM-së, u angazhuan edhe shoqëria civile, grupet e interesit, e shumë kontribuues të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë. Për ecurinë e këtij procesi janë informuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, institucionet pjesëmarrëse, trupa diplomatike, media dhe opinioni publik. Po ashtu, janë organizuar takime e bërë disa publikime nga qendra e institute kërkimore “think tank”.

Në procesin e RSM-së u përfshinë mbi 150 ekspertë civilë dhe ushtarakë, si dhe disa qindra të tjerë u konsultuan me të drejtën e dhënies së mendimit (feedback).

Organizimi i procesit të RSM-së u bë në 6 faza kryesore të ndërlidhura ngushtë midis tyre:

- Faza I përfshin ngritjen e një grupi ndërministror të punës për RSM-në, të grupeve të punës për çdo ministri, ngritjen e sekretariatit të RSM-së, si dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në interes të procesit. Në këtë fazë u krye informimi, trajnimi në seminare dhe shkëmbimi i mendimeve mbi procesin, u vlerësua përvoja e RSM-ve të kaluara, aspektet ligjore, çështje kulturore e të trashëgimisë së institucionit të mbrojtjes etj.

- Faza II përfshin aspekte të përcaktimit të kuadrit të politikës së sigurisë kombëtare, nëpërmjet analizës së dokumenteve ekzistuese strategjike kombëtare, si dhe përgatitjes së vlerësimit të mjedisit strategjik në nivel kombëtar. Gjatë kësaj faze vijoi identifikimi i objektivave dhe interesave kombëtare, si dhe përcaktimi i rolit dhe i misionit të ministrive dhe agjencive të ndryshme të përfshira në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.

- Faza III përfshin përpunimin e skenarëve të planëzimit lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit në perspektivën afatmesme dhe afatgjatë. Për çdo skenar u përcaktua roli drejtues, koordinues apo mbështetës i të gjitha institucioneve të sigurisë. Fokusi kryesor në këtë fazë ishte identifikimi i

¹ Institucionet pjesëmarrëse në RSM janë: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Informativ Kombëtar.

kërkesave për kapacitete ushtarake të institucionit të mbrojtjes, si dhe i kapaciteteve të tjera të komponentëve politikë, ekonomikë, informativë, socialë, mjedisorë etj.

- Faza IV përfshin zhvillimin e një analize të detajuar të kapaciteteve të forcës së ardhshme të dalë nga përpunimi i skenarëve të planëzimit. Bazuar në metodën krahasimore të kapaciteteve alternative të forcës, në këtë fazë u përcaktuan prioritetet kryesore të kapaciteteve ushtarake të forcës së ardhshme. Çështje kryesore e kësaj faze ishte edhe krahasimi i kapaciteteve të strukturës ekzistuese të forcës me atë të ardhshme, duke vlerësuar si boshllëqet/mangësitë e kapaciteteve, ashtu dhe tepricat e tyre.

- Faza V përfshin gjetjet dhe zhvillimin e alternativave për kapacitetet e kërkuara, duke i parë ato të lidhura ngushtë me aspektet financiare. Në këtë fazë, bazuar në misionin e FASH-it për përmbushjen e skenarëve strategjikë, prioritetet e kapaciteteve ushtarake e civile, si dhe mundësitë financiare për zhvillimin e tyre në perspektivën afatmesme, u propozua kursi më i mirë i veprimtimit për autoritetet vendimmarrëse në nivel strategjik.

- Faza VI përfshin paraqitjen e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore të RSM-së, për zhvillimin e forcës së ardhshme.

Një skemë principate e procesit të RSM-së jepet në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

KREU II

SUPOZIMET DHE PARAMETRAT E PLANIFIKIMIT TË MBROJTJES

II.1 INTERESAT DHE KONCEPTI I SIGURISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

II.1.1 Interesat kombëtare të RSH-së

Interesat kombëtare kryesore të RSH-së lidhen ngushtë me: sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të vendit; zhvillimin e një sistemi social-ekonomik të qëndrueshëm, me mirëqenie dhe siguri për qytetarët e vet; konsolidimin e një shteti ligjor funksional dhe një rend kushtetues të zhvilluar demokratik; integrimin në institucionet europiane, euroatlantike dhe globale; promovimin e një mjedisi rajonal në paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm; mbrojtjen e vlerave e pasurive kombëtare dhe të të drejtave të shqiptarëve; respektimin e lirive dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të pakicave kombëtare etj.

Interesat kombëtare të RSH-së janë në themel të zhvillimit të sistemit të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit. Si vend aleat, interesat kombëtare të RSH-së ndërthuren me ato të aleancës. Strategjia e sigurisë së RSH-së mbështet fuqimisht parimin e mbrojtjes kolektive të një aleance të fortë dhe të qëndrueshme. Interesat dhe objektivat kombëtarë përbëjnë bazën për misionin dhe detyrat e FASH-it, të shprehura në kapitullin II.3.

II.1.2 Koncepti i sigurisë së RSH-së

Interesat dhe objektivat e RSH-së në shekullin e ri kanë sjellë një evoluim të konceptit të sigurisë. Në një botë gjithmonë e më shumë të globalizuar, Shqipëria i përmbahet parimit se nuk mund të ketë siguri kombëtare pa siguri rajonale dhe globale. Ajo vlerëson si prioritet strategjik integrimin në organizmat rajonale dhe ndërkombëtarë të sigurisë.

Shqipëria sot është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), si dhe synon të jetë anëtare e Bashkimit Europian (BE). Ajo merr, gjithashtu, pjesë aktive në shumë iniciativa të bashkëpunimit e të sigurisë rajonale².

² Disa nga iniciativat rajonale kryesore ku Shqipëria merr pjesë janë: Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP); Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC); Iniciativa e Europës Qendrore (CEI); Iniciativa e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SECI); Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC); Iniciativa e Adriatik-Jonit (AII); Qendra Rajonale e Armkontrollit dhe Verifikimit (RACVIAC); Partneritetin e



Koncepti Strategjik i sigurisë dhe i mbrojtjes së vendit mbështetet në Kushtetutën e RSH-së, në Strategjinë e Sigurisë dhe Strategjinë Ushtarake të RSH-së. Si vend aleat, ky koncept bazohet edhe në konceptin strategjik të aleancës 2010, me përfitimet dhe detyrimet ndaj mbrojtjes kolektive të nenit 5 të traktatit të Washingtonit³. Si vend që punon për të qenë pjesë e BE-së, Shqipëria mban, gjithashtu, në konsideratë edhe angazhimet ndaj konceptit të CSDP-së⁴ dhe Strategjisë së Sigurisë Europiane.

Në këtë kontekst, operacionet e sotme dhe të ardhme të FASH-it do të zbatojnë konceptin e “përqasjes gjithëpërfshirëse”⁵. Ato do të karakterizohen nga një pjesëmarrje e gjerë e kapaciteteve ushtarake dhe civile, si dhe agjencive qeveritare dhe joqeveritare. Sipas rastit, në vartësi të shtrirjes, vendit, rëndësisë dhe intensitetit të tyre, pjesëmarrja e FASH-it në operacionet e sotme dhe ato të ardhshme, do të kryhet nën konceptin “joint”, ndëragjenci dhe multinacionale.

II.2 MJEDISI STRATEGJIK I SIGURISË

Gjendja e mjedisit aktual dhe të pritshëm të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale është pika e referimit për përpunimin e skenarëve të përdorimit të FASH-it dhe të institucioneve të tjera të sigurisë në situatë paqeje, tensioni, krize dhe lufte. Ky mjedis është, gjithashtu, vendimtar për përcaktimin e kapaciteteve ushtarake të ardhshme të FASH-it.

Mjedi i sigurisë i RSH-së dhe i rajonit tonë është dhe pritet të jetë një mjedis kompleks. Nga njëra anë, kemi zhvillime të ndjeshme pozitive dhe mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik, paqe, stabilitet dhe siguri rajonale, dhe nga ana tjetër kemi sfida dhe rreziqe të reja të sigurisë, të cilat kërkojnë mirëkuptim, dialog dhe frymë bashkëpunimi.

II.2.1 Shanset/mundësitë e mjedisit të sigurisë rajonale

Vendi dhe rajoni ynë ka sot një mjedis të sigurisë shumë herë më të favorshëm se 10-20 vjet më parë. Po ashtu, prezenca e NATO-s, BE-së dhe e organizmave të tjerë në rajon vazhdon të mbetet një faktor i ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme e të stabilitetit rajonal.

Rajoni ynë tashmë përbëhet nga vende aleate, nga vende aspirante apo partnere me NATO-n ose me BE-në. Reformat e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendeve të rajonit nuk kanë synime të hapura të konfrontimit konvencional me njëri-tjetrin. Kjo pasqyrohet nëpërmjet zhvillimit të forcave të vogla profesioniste me kapacitete kryesisht mbrojtëse, nën mbikëqyrjen e autoriteteve civile.

Format e bashkëpunimit rajonal kanë dhe pritet të kenë një shtrirje në rritje në fushën politike, ekonomike dhe atë të sigurisë. Si asnjëherë më parë, kemi krijuar të njëjsete të përbashkëta rajonale, pjesëmarrje në operacione të përbashkëta, ndihmë reciproke në emergjencat civile etj. Ky bashkëpunim pritet të shtrihet më tej në kuadrin e një “smart defence” rajonal në zhvillim.

II.2.2 Rreziqet ndaj sigurisë së RSH-së

Duke pasur parasysh të gjithë spektrin kombëtar, rajonal dhe global të rreziqeve që mund t'i kanosen RSH-së, tani dhe në të ardhmen, ato mund t'i klasifikojmë në 4 kategori kryesore: në rreziqe të natyrës konvencionale; në rreziqe të natyrës jokonvencionale dhe asimetrike; në rreziqe që vijnë nga faktorë natyrorë, industrialë dhe njerëzorë; si dhe në rreziqe të emërtuara (sfidat në zhvillim ndaj sigurisë).

Rreziqe konvencionale. Këto rreziqe tradicionale, që konfliktikojnë shtetet apo grup-shtetet kundër njëri-tjetrit, kanë pësuar dhe pritet të pësojnë një rënie të ndjeshme në perspektivën e afërt dhe të mesme. Superioriteti ushtarak konvencional i aleancës dhe prezenca e saj në rajon ka shumë

Kartës së Adriatikut (A-5); Ministerialin e Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM), si dhe pjesëmarrjen në Brigadën e Europës Juglindore (SEEBRIG) etj.

³ Neni 5 i traktatit të Washingtonit, Washington D.C., SHBA, 4 prill 1949.

⁴ EU Common Security and Defence Policy (Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe e Mbrojtjes e BE-së).

⁵ “Përqasja gjithëpërfshirëse” nënkupton pjesëmarrjen e gjithë institucioneve të sigurisë kombëtare në operacionet kombëtare “whole government approach”; si dhe e shumë institucioneve ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare në operacionet ndërkombëtare “comprehensive approach”.

mundësi të shkurajojë agresionet ushtarake konvencionale të nivelit strategjik ndaj saj, vendeve anëtare të saj, si dhe ndaj zonave ku ajo ka interesa strategjike. Me gjithë zhvillimet pozitive, përpjekjet për ndryshimin e kufijve me dhunë, nacionalizmi ekstrem, përplasja e grupimeve etnike, kulturore, ideologjike, fetare apo të konfiguracioneve të tjera që i kalojnë kufijtë shtetërorë, mund të vazhdojnë të mbeten rrezeqe konstante ndaj sigurisë rajonale edhe në vitet në vijim.

Rrezeqe jokonvencionale dhe asimetrike. Këto rrezeqe që nuk njohin kufij shtetërorë, bazohen në konfrontimin midis shteteve kombe dhe aktorëve joshtetërorë. Ato pritet të jenë një dukuri në rritje në vitet në vijim dhe mund të vijnë nga terrorizmi, lëvizjet ekstremiste, shtetet e dështuara, aktivitetet e paligjshme, krizat e ndryshme etj. Këto rrezeqe mund të jenë të natyrave, kulturave, ideologjive dhe qëllimeve të ndryshme dhe mund të përdorin forma më të sofistikuara, teknologji më të avancuara, metoda më diversive e destabilizuese dhe me efekte mediatike për opinionin publik. Shqipëria mund të angazhohet kundër kundërshtarëve joshtetërorë të saj dhe të aleancës në kuadrin kombëtar, atë transnacional dhe ndërkombëtar.

Rrezeqe nga faktorët natyrorë, industrialë dhe njerëzorë. Rrezeqe të tilla janë të natyrës së emergjencave civile dhe që ka gjasa të vijnë në rritje. Këto janë rrezeqe të paqëllimshme, që krijohen nga shkaqe natyrore apo pakujdesi industriale e njerëzorë. Përballimi i tyre mund të kërkojë angazhimin e komponentit ushtarak në rol mbështetës, kur përmasat e pasojave të tyre i tejkalojnë mundësitë e autoriteteve civile.

Sfidat në zhvillim ndaj sigurisë. Këto sfida të shekullit të 21-të, mund të zhvillohen si rrezeqe potenciale për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit tonë, që e kanë origjinën te pjesëmarrja e vendit tonë në mbrojtjen kolektive të aleancës dhe, si të tilla, do të përballohen kryesisht në këtë kuadër. Ndër to mund të veçojmë: përhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM); zhvillimin e kapaciteteve raketore balistike jashtë aleancës; sulmet kibernetike, kërcënimet hibride; sfidat ndaj sigurisë së energjisë dhe burimeve të rralla; pirateria detare etj.

II.3. MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FASH-it NË MJEDISIN E SIGURISË

FASH kanë një rol vendimtar në sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Ky kre artikulon rolet, misionin, objektivat ushtarakë të FASH-it, nivelin e ambicies, si dhe çështje të ndërveprimit të tyre.

Misioni dhe objektivat ushtarakë të FASH-it

Bazuar në Kushtetutën e RSH-së, ... “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues⁶, ndërsa ligji për strategjinë ushtarake shprehet se: “... misioni i Forcave të Armatosura është ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtja dhe mbështetja e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënia e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e me gjerë⁷.

Forcat e Armatosura të RSH-së kanë hapësirën kushtetuese për t’u përgatitur dhe për t’u angazhuar në të gjithë skenarët strategjikë të sigurisë, në rol kryesor, mbështetës apo kontribuues. Përdorimi i fuqisë ushtarake do të përdoret sipas rastit, në kohë paqeje, tensioni, krize dhe lufte. Në këtë kontekst, FASH përgatiten dhe angazhohen për arritjen e tre objektivave kryesorë ushtarakë:

a) Objektivi ushtarak 1. Ky objektivi ka si synim garantimin e sovranitetit, pavarësisë dhe mbrojtjes së territoreve të vendit nga një agresion i mundshëm nga jashtë. Ky është objektivi ushtarak themelor ku FASH luajnë rol kryesor. Për përmbushjen e tij, FASH koordinojnë skenarët e planëzimit kombëtar me ata të aleancës. Po ashtu, Shqipëria u përmbahet detyrimeve të nenit 5 të mbrojtjes kolektive të aleancës, për zhvillimin e objektivave të kapaciteteve (Capability Targets)⁸.

b) Objektivi ushtarak 2. Ky objektivi ka të bëjë me angazhimin e FASH-it brenda vendit për mbrojtjen dhe mbështetjen e autoriteteve civile dhe të popullit shqiptar. Ky është një objektivi i

⁶ Kushtetuta e RSH-së, neni 12, pika 2.

⁷ Strategjia Ushtarake 2007, kapitulli 4, pika 4.1.

⁸ Objektivat e kapaciteteve (Capability Targets) janë kapacitete ushtarake dhe civile që vendi ynë i vë në dispozicion të aleancës në kuadrin e nenit 5 të mbrojtjes kolektive.



rëndësishëm i FASH-it, ku ato luajnë rol mbështetës. Për përmbushjen e tij, FASH mbështet institucionet e tjera të shtetit në kohë paqeje, krize dhe lufte, sipas autoritetit që u jep ligji. Ato vënë në dispozicion kapacitetet e tyre në përputhje me planet e kontigjencave (të situatave të veçanta), për emergjencat kombëtare dhe operacione të tjera.

c) Objektivi ushtarak 3. Ky objektivi lidhet me angazhimin e FASH-it për mbështetjen e paqes dhe të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Ky është një objektivi tjetër i rëndësishëm i FASH-it, ku ato luajnë rol kontribuues. Për përmbushjen e tij, ato përgatiten për të kontribuar me kapacitetet përkatëse në misionet për menaxhimin e krizave dhe ato të mbështetjes së paqes. Po ashtu, ato mund të angazhohen edhe në veprimtari të tjera joluftarake, si ato të asistencës trajnuese dhe këshilluese, ndërtimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes, si dhe programet e bashkëpunimit ushtarak.

Për përmbushjen e 3 objektivave kryesorë ushtarakë, FASH koordinon veprimet e tyre me instrumentet e tjera të fuqisë kombëtare, sipas konceptit të gjithëpërfshirjes, duke angazhuar sipas ligjit të gjitha kapacitetet e vendit, publike apo private. Po ashtu, ato planëzojnë, trajnohen, pajisen dhe koordinon me forcat aleate qysh në kohë paqeje.

Niveli i ambicies (NiA) i RSH-së

NiA e RSH-së nënkupton kapacitetet e dëshiruara ushtarake e civile për pjesëmarrje të njëhershme në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, më vete ose me aleatët, bazuar në kohëzgjatjen dhe rotacionet e mëtejshme të tyre. Niveli i ambicies (NiA) së vendit tonë shprehet në rastet e mëposhtme:

- NiA për mbrojtjen kombëtare dhe kolektive të nenit 5 (CD). NiA e RSH-së për mbrojtjen e vendit në bashkëpunim me forcat aleate, sipas nenit 5, është deri në një brigadë të përforcuar (brigadë *task force*) ose deri tri grup-batalione të përforcuara. Ndërsa, kontributi i RSH-së për mbrojtjen kolektive të territoreve të aleancës, sipas procesit të NDPP⁹, është 1 grupim taktik “grup-batalion i këmbësorisë së lehtë të motorizuar”¹⁰, me angazhim 6 muaj deri në një vit, pa rotacion të mëtejshëm, të konfiguruar sipas misionit konkret.

- NiA për pjesëmarrje në përgjigjen ndaj krizave jashtë nenit 5 (NA5CRO). NiA e FASH-it për pjesëmarrje në operacione NA5CRO¹¹, jashtë nenit 5, kryhet mbi bazën e konceptit të “një grupimi të vetëm forcash” për NATO/BE/OKB apo koalicione të mundshme, përtej kufijve kombëtarë dhe aleatë. Ky NiA është jo më shumë se tri kompani njëherësh në operacion, me rotacion disaherësh. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të specializuara “Niche”, grupe të forcave speciale/komando, si dhe ekspertë (civilë dhe ushtarakë) trajnues, këshillues, koordinatorë, vëzhgues etj., sipas sistemit të ponderimit të forcës, të pranuar nga aleanca.

- NiA për përballimin e Emergjencave Civile (EC). NiA e FASH-it për përballimin e emergjencave civile në mbështetje të autoriteteve në emergjencat civile brenda vendit është mbështetja e një emergjence në nivel batalioni të përforcuar (batalion *task force*), ose e dy emergjencave të njëkohshme në nivel kompanie të përforcuar (kompani *task force*). Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme, apo kur FASH sjellin një ekspertizë të veçantë, që nuk disponohet nga institucionet e tjera.

Ndërveprimi/standardizimi i FASH-it me aleancën

Në kuadrin e “përqasjes gjithëpërfshirëse”, operacionet e sotme dhe ato të ardhshme të njëjësive të FASH-it do të kryhen nën konceptin “joint”, ndëragjenci dhe multinacionale. Për këtë qëllim, ato do të jenë një forcë e ndërveprueshme brenda komponentëve të saj, me institucionet dhe

⁹ Paketa e objektivave të kapaciteteve të “Blue Book” të Republikës së Shqipërisë në NDPP (NATO Defence Planning Process).

¹⁰ Ky grup-batalion e ka kodin e kapaciteteve INF-MOT-BN, sipas “NATO Capability Codes and Statements”.

¹¹ NA5CRO - Non-Article 5 Crisis Response Operations - janë operacionet jashtë nenit 5 që kryhen nga aleanca në përgjigje të krizave.

agjencitë e tjera kombëtare, si dhe me forcat aleate. Ndërveprimi dhe standardizimi sipas STANAG-eve të NATO-s do të përfshijë fushat operacionale, materiale dhe administrative.

II.5 Supozimet bazë të RSM-së

Supozimet bazë, mbi të cilat u ngrit procesi i kësaj RSM-je, ishin si më poshtë:

- Rishikimi strategjik i mbrojtjes zhvillohet në kontekstin e koordinimit midis mbrojtjes individuale të vendit dhe mbrojtjes kolektive, sipas parimeve të NATO-s.

- Analizat rreth risqeve për sigurinë kombëtare tregojnë se mjedisi i sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, nuk do të ketë ndryshime të ndjeshme nga ato që parashikohen në këtë dokument.

- Konsiderimi i ritmeve të rritjes ekonomike në terma afatmesëm, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave.

- Konsiderimi i alokimit të buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes, në përputhje me të dhënat e parashikuara në terma vjetorë dhe afatmesëm prej Ministrisë së Financave.

- Madhësia e Forcave të Armatosura.

- Përmeshja e detyrimit ndaj aleancës për zhvillimin e kapaciteteve kritike të kërkuara si detyrim parësor për zhvillimin afatmesëm të forcës së armatosur.

Mbi këto supozime të fiksuara, u ndërmor ushtrimi për evidentimin dhe argumentimin e alternativës më të përshtatshme për krijimin një force të armatosur efikase dhe ndërvepruese, e cila do të zhvillohet në kushtet e balancës mes burimeve dhe ambicieve.

Për të arritur në këtë përfundim të synuar, RSM përdori këtë logjikë ushtrimore:

- Shpërndarja e buxhetit të mbrojtjes duhet t'i përafrohet sa më shumë të jetë e mundur raportit ideal 35% për personelin, 35% për operacionet dhe mirëmbajtjen, 30% investimet, raport sipas të cilit planifikojnë shumica e vendeve anëtare të NATO-s.

- Eliminimi nga buxheti i mbrojtjes, i zërit të pensioneve ushtarake së bashku me paratë e alokuara në të, me qëllim analizimin vetëm të buxhetit të mbrojtjes në vetvete, pasi ky rast është përjashtimor dhe i përkohshëm për Forcat e Armatosura Shqiptare.

Kreu III në vijim, ofron pikërisht analizën e detajuar që iu bë gjatë procesit të RSM-së, buxhetit të mbrojtjes në terma afatmesëm.

KREU III

MBËSHTETJA ME BURIME E FASH-it

Në këtë kre, analizohet perspektiva e mbështetjes me burime të FASH-it në terma afatmesëm, së bashku me prirjet e zhvillimit ekonomik dhe financiar të vendit, në terma makroekonomikë.

III.1 Programet buxhetore të FASH-it, prirjet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe mbështetja me burime e FASH-it 2013-2020

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë operon me 7 programe buxhetore, të cilat janë fleksibël për t'u përshtatur sipas nevojave të modernizimit të FA-së apo të integritimit. Këto programe janë:

1. Programi 01110 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi";
2. Programi 02120 "Forcat e luftimit";
3. Programi 02150 "Mbështetja e luftimit";
4. Programi 02280 "Bashkëpunimi civilo-ushtarak (CIMIC)";
5. Programi 09430 "Arsimimi ushtarak";
6. Programi 07340 "Mbështetja shëndetësore";
7. Programi 10270 "Mbështetja sociale për ushtarakët".

Parashikimet e Ministrisë së Financave për mbështetjen me burime të mbrojtjes gjatë periudhës afatmesme, variojnë (në terma absolutë) nga rreth 19.000.000 lekë (për vitin 2012) në rreth 20.000.000 lekë (për vitin 2020) ose mesatarisht 1.3 % deri në 1.2 % të GDP-së, krahasimisht me parashikimin për ritmet e rritjes së GDP-së në periudhën e marrë në shqyrtim.



Në përputhje me supozimet kryesore, që u renditën në kreun paraardhës, u eliminuan prej këtij buxheti të alokuar, zëri i pensioneve të ushtarakëve, së bashku me paratë e alokuara nën këtë zë, prej nga rezultoi se mbështetja me burime e mbrojtjes në funksion të zhvillimit të kapaciteteve, faktikisht realizohet në masën 70 % të buxhetit total vjetor të alokuar (30 % shkon në favor të pensioneve të ushtarakëve).

III.2 Vlerësimi i kërkesave buxhetore të FASH-it dhe kapaciteteve të kërkuara nga RSM

Nisur nga këto vlerësime, RSM analizoi potencialin e zhvillimit të kapaciteteve të FASH-it, në terma afatmesëm, duke vendosur si prioritet të parë transformimin e FASH-it, në përputhje me zhvillimin e atyre kapaciteteve që NATO i konsideron si kapacitete kritike për aleancën.

Transformimi i FASH-it në këtë drejtim, bëhet i mundur nëse arrihet synimi për shpërndarjen racionale të shpenzimeve për kategoritë kryesore të buxhetit të mbrojtjes: personeli, operacionet dhe mirëmbajtja, si dhe investimet, pasi vetëm një mbështetje e balancuar financiare mund të sigurojë personel të motivuar, të mirëtrajnuar dhe që posedojnë pajisje moderne të mirëmbajtura.

Për këtë arsye, RSM mori përsipër të analizonte sesi do të mund të zhvillohen kapacitetet e FASH-it në terma afatmesëm, nëse mbështetja me burime do të realizohej sipas raportit ideal të balancimit të buxhetit:

- 35 % personel;
- 35 % operacione dhe mirëmbajtje;
- 30 % investime,

gjithmonë, duke mbajtur parasysh se buxheti i mbrojtjes mbështet kapacitetet vetëm në masën 70 % të totalit të alokuar çdo vit.

Analiza tregoi se ky raport nuk mundet të qëndrojë pastërtish i tillë dhe të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve transformuese, të paktën në terma afatmesëm, ku përqendrohet ky RSM, nëse supozimet fillestare për madhësinë e forcës së armatosur dhe struktura e shpërndarjes së buxhetit, mbeten të pandryshuara.

Përkundrazi, raporti vjen në përmirësim, pra çon drejt një zhvillimi të balancuar të kapaciteteve të FASH-it me burimet që i janë alokuar, vetëm në rast se madhësia e forcës së armatosur vjen në reduktim dhe buxheti i alokuar vjen në tendencë rritjeje ose të paktën mbetet në nivelet e parashikuara (rreth 19.000.000 - 20.000.000 lekë), por balancohet korrektësisht mes shpenzimeve për personelin, operacionet dhe mirëmbajtjen, dhe investimeve.

Duke punuar në këta terma, analiza e RSM-së arriti në përfundimin se ulja e numrit të personelit nga 10,190 në fund të vitit 2012 në rreth 8,500 vetë në fund të vitit 2015, mundëson rialokimin e fondeve për të ruajtur dhe për të forcuar kapacitetet operacionale ekzistuese, duke mbajtur zhvillimin e kapaciteteve të forcës së armatosur në nivelin optimal.

Atëherë, RSM formuloi rekomandimin se alternativa e një force të armatosur OPTIMUM, është alternativa më e mirë për të balancuar kapacitetet e kërkuara operacionale dhe mbështetëse me burimet që pritet të vihen në dispozicion të mbrojtjes në periudhën afatmesme.

III.2 Kapacitetet operacionale dhe mbështetja me burime 2013-2020 për një forcë OPTIMUM

Për mbështetjen e kapaciteteve operacionale të FASH-it, resurset financiare në mbështetje të FASH-it për vitet 2013-2020, shpërndahen si më poshtë:

- 70 % e shpenzimeve buxhetore vjetore do të konsiderohen “shpenzime operacionale” dhe do të mbështetin strukturat e FA-së për përmbushjen e misionit të tyre.
- 30 % e shpenzimeve buxhetore vjetore do të konsiderohen “shpenzime jooperacionale” dhe do të mbështetin shpenzimet për pensionet e ushtarakëve, operacionet jashtë vendit dhe shpenzimet për kërkim-zhvillimin në FA.

Shpenzimet operacionale të parashikuara për vitet 2013-2020 shpërndahen si më poshtë:

- 60 % e shpenzimeve “operacionale” në mbështetje të strukturave të përfshira në skenarët e RSM-së;

- 40 % e shpenzimeve “operacionale” në mbështetje të strukturave, të cilat nuk përfshihen në skenarët e RSM-së.

III.3 Plani i mbështetjes me burime për një forcë OPTIMUM në periudhën 2013-2020

Mbështetja e FASH-it me burime për realizimin e objektivave kryesorë të dokumenteve strategjike dhe arritjen e kapaciteteve operacionale të planifikuara për vitet 2013-2020, sipas planifikimit afatmesëm pritet të bëhet si më poshtë:

1. Shpenzimet operacionale

- Shpenzime për personelin

Shpenzimet për personelin do të përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore. Ato do të jenë nga 6,692 milionë lekë (50.2 %) në vitin 2013 deri në 7.269 milionë lekë (46.7 %) në vitin 2020.

Mbështetja e nevojshme financiare për personelin do të shikohet si prioritet kryesor, me qëllim që të ruhen kapacitetet e krijuara të resurseve njerëzore.

Numri i personelit do të ketë një reduktim gradual nga 10,190 në fillim të vitit 2013 në rreth 9,000 në vitin 2014, duke pasur si objektiv arritjen e numrit 8500 vetë në fund të vitit 2015. Ky numër presupozohet të mbetet konstant deri në vitin 2020.

- Shpenzime për operacionet dhe mirëmbajtjen

Shpenzimet për operacionet dhe mirëmbajtjen do të jenë nga 3,394 milionë lekë (25.5%) në vitin 2013 deri në 4,445 milionë lekë (28.6%) në vitin 2020. Rritja e operacionalitetit në FASH do të synojë të jetë në proporcion të drejtë me modernizimin e pajisjeve dhe teknologjisë që parashikohet të futet gjatë kësaj periudhe në FASH.

- Shpenzime për investimet

Shpenzimet për investimet do të jenë nga 3,242 milionë lekë në vitin 2013 deri në 3,853 milionë lekë në vitin 2020.

Investimet e parashikuara për këtë periudhë do të mbështesin objektivat e forcës të parashikuar për t'u realizuar në vitet në vijim ku prioritet do të jenë:

- përfundimi i projektit të helikopterëve dhe të anijeve patrulluese;
- pajisjet për grup-batalionin;
- pajisjet e kërkim-shpëtimit,
- armatimi individual i FA-së;
- modernizimi i mjeteve të transportit;
- pajisjet luftarake individuale;
- pajisjet SNI etj.

Investimet në infrastrukturë do të synojnë përmirësimin e kushteve për punë, jetesë dhe stërvitje të efektive. Prioritet kryesor do të ketë baza ajrore e Kuçovës dhe garnizonet e FT-së.

Në total vlera e shpenzimeve operacionale të mbrojtjes zë rreth 70 % të buxhetit të mbrojtjes.

- Shpenzime jooperacionale

Në këtë grup-shpenzimesh përfshihen shpenzimet për pensionet e ushtarakëve; shpenzimet për operacionet jashtë vendit dhe shpenzimet për kërkim-zhvillimin. Në total, vlera e këtyre shpenzimeve zë rreth 30 % të buxhetit të mbrojtjes.

KREU IV

KAPACITETET E FORCËS SË ARDHSHE TË RSH-së

Kapacitetet e forcës së ardhshme të RSH-së për përmbushjen e misionit të tyre kushtetues, bazohen në misionin, objektivat ushtarakë, skenarët e planëzimit, si dhe pritjet e zhvillimeve politike, ushtarake dhe financiare.



IV.1 Metodologjia e planifikimit të mbrojtjes

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve, në themel të këtij RSM është planifikimi i bazuar në kapacitetet, të balancuara me burimet (PBK). Analiza e RSM-së bazohet në vlerësimin e rreziqeve, sfidave dhe mundësive të mjedisit të sigurisë. Zhvillimi i paketës së kapaciteteve të mbrojtjes është mbështetur në vlerësimin e prirjeve themelore të zhvillimit të situatës së sigurisë globale, rajonale e kombëtare.

Rreziqet, kërcënimet, sfidat dhe shanset e identifikuar gjatë analizës, janë konkretizuar gjatë procesit të RSM-së në fusha të planifikimit strategjik dhe në skenarë të përgjithshëm strategjikë. Më tej, skenarët strategjikë janë përpunuar në kushte të një planifikimi operacional, prej nga kanë rezultuar edhe kapacitetet e domosdoshme për përballimin e çdo skenari. Gjatë procesit, u morën në konsideratë aspekte të planifikimit të NATO-s në interes të mbrojtjes kolektive.

Rezultatet e PBK-së, kapacitetet e kërkuara operationale, u harmonizuan më tej me resurset në dispozicion të mbrojtjes, duke rezultuar në paketat e kapaciteteve operationale dhe ato mbështetëse të forcës së ardhshme. Synimi kryesor i metodologjisë së PBK-së është arritja e dakordësisë për një kalendar të zhvillimit të një force të ardhshme të besueshme dhe të përballeshme.

Fushat e planëzimit strategjik

Analiza e misionëve të çdo institucioni të sigurisë së RSH-së në katër situatat e sigurisë, solli identifikimin e gjashtë fushave strategjike të planëzimit, të cilat janë:

- Fusha 1 - Mbrojtja e vendit;
- Fusha 2 - Kontributi për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar;
- Fusha 3 - Mbrojtja e rendit kushtetues;
- Fusha 4 - Siguria publike;
- Fusha 5 - Emergjencat civile;
- Fusha 6 - Siguria kibernetike.

IV.2 Skenarët e planëzimit të FASH-it

Si rezultat i analizës së fushave të planëzimit strategjik u zhvilluan skenarët strategjikë të mbrojtjes. Skenarët strategjikë u ngritën mbi bazën e analizës së thelluar të rreziqeve, kërcënimeve, sfidave, shanseve, si dhe mbi supozimet, pritshmëritë dhe kufizimet të evidentuara në kreun 2. Një listë e skenarëve të planëzimit është dhënë në shtojcën 2.

Spektri i skenarëve të identifikuar dhe të analizuar shtrihet që nga cenimi i sovranitetit kombëtar nga rreziqe të kufizuara ushtarake të jashtme deri te fatkeqësitë serioze natyrore të brendshme.

Skenarët e planifikimit strategjik bazohen në një qasje analitike të çështjeve si vijon: situata e përgjithshme, qëllimi strategjik, objektivat, vlerësimi i rrezikut, pritjet/supozimet, kufizimet e ndryshme, si dhe përshkrimi i situatave operationale përkatëse, prej të cilave u përcaktuan misionet dhe konceptet operationale për çdo institucion pjesëmarrës në to.

Kjo përjasje gjeneroi kërkesa operationale për çdo skenar të veçantë, të cilat u shprehen në kapacitetet përkatëse dhe në struktura alternative të forcës. Forca e ardhshme është forca që balancon setin e kapaciteteve të gjeneruara nga procesi i RSM-së me setin e rreziqeve dhe sfidave të ardhshme, në kuadrin e burimeve të disponueshme në perspektivën afatmesme.

Pritjet janë që pjesëmarrja e FASH-it në skenarët e operationeve jashtë vendit nuk do të kryhen asnjëherë më vete, ndërsa në skenarët brenda vendit, operationet e tyre mund të kryhen më vete ose së bashku me institucione e agjenci të tjera kombëtare të sigurisë. Operationet më vete të FASH-it do të jenë kryesisht të natyrës “jonit”. Për ilustrim, shtojca 3 jep një përmbledhje të rolit të FASH-it dhe të institucioneve të tjera në kohë lufte.

Analiza e skenarëve dhe identifikimi i misioneve

Mbi bazën e spektrit të konfliktit dhe variablat e intensitetit të angazhimit të forcave të sigurisë në paqe, tension, krizë, luftë apo pasluftë, janë përcaktuar jo vetëm kapacitetet e nevojshme të Forcave të Armatosura, por dhe ato të ministrive e institucioneve të tjera.

Përcaktimi i kapaciteteve për përballimin e skenarëve, rezultoi në ndërtimin e profileve të kapaciteteve, që në vetvete përfshijnë: misionin kryesor apo mbështetës në përballimin e skenarit, misionet dhe detyrat e çdo institucioni pjesëmarrës, një numër kushtesh për përmbushjen e detyrave (kushte fizike, civile dhe ushtarake), si dhe kapacitetet që çdo institucion ofron. Në përfundim, kapacitetet u është dhënë një prioritet i angazhimit sipas kohëve të gatishmërisë së kërkuar.

Krahasimi i skenarëve me njëri-tjetrin, si dhe vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së tyre në të njëjtën kohë, shërbeu për përcaktimin e kapaciteteve të forcës së ardhshme. Struktura e forcës së ardhshme përfaqëson kombinimin më të vështirë të pritshëm, atë të ballafaqimit të FASH-it me disa skenarë të njëkohshëm, duke mbajtur, gjithashtu, në konsideratë disa rotacione. Forca e parashikuar për këtë rast, konsiderohet si alternativa më ideale, e zhvilluar në kushtet e mbështetjes së pakufizuar financiare. Shtojca 4 jep një tabelë të mundësisë së ndodhjes së njëkohshme të skenarëve dhe krahasimit të tyre.

Vlerësimi i prioritetit të skenarëve

Përcaktimi i prioritetit të skenarëve mban parasysh kushtet ekonomike, politike, ushtarake, social-kulturore, teknologjike dhe mjedisore. Përcaktimi i prioriteteve mes skenarëve është bazuar në rëndësinë relative të skenarëve në raport me njëri-tjetrin, si dhe peshën specifike që ata zënë në raport me sigurinë kombëtare. Sipas këtij parimi, skenarët që kanë të bëjnë me përballimin e rreziqeve të mëdha të jashtme për sigurinë kombëtare, si dhe ata që kanë të bëjnë me rreziqe të mëdha me karakter natyror e njerëzor, renditen në krye të listës së prioriteteve. Shtojca 5 jep një tabelë të vlerësimit të prioritetit të skenarëve.

IV.3 Kërkesat dhe kapacitetet e strukturës së ardhshme

Struktura e ardhshme e FARSH-it do të ketë një përbërje të balancuar të kapaciteteve për të përmbushur të gjitha misionet e mundshme, më vete ose në përbërje të mbrojtjes kolektive. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve pritet të përballlet me kufizime të resurseve në planin afatmesëm dhe afatgjatë, si pasojë e impakteve të krizës ekonomiko-financiare globale. Në këto kushte, politika e qeverisë në fushën e mbrojtjes synon të mbështesë programet prioritare me efekt kryesor në kapacitetet e mbrojtjes.

Fushat e kapaciteteve operacionale

Forcat e Armatosura të RSH-së do të zhvillojnë kapacitetet e nevojshme operacionale, të cilat ndahen në kapacitete të luftimit dhe kapacitete të mbështetjes. Bazuar në analizën e kërkesave operacionale për përballimin e skenarëve, në analizën e burimet financiare të parashikuara për mbrojtjen, në analizën e detyrimeve të vendit tonë si anëtar i NATO-s dhe në paketën e kapaciteteve të mbrojtjes (Capability Targets 2013-2019), si dhe duke marrë në konsideratë madhësinë e rekomanduar prej 8500 vetash të forcës së ardhshme, evidentohen si kapacitetet më të domosdoshme të FARSH-it:

a) Kapacitete të luftimit

Sasia e përgjithshme e forcave të luftimit planëzohet të jetë 3000 vetë dhe do të përbëhet nga:

- Batalioni I i Këmbësisë/Kompania e Mbrojtjes së Armëve të Dëmtimit në Masë;
- Batalioni II i Këmbësisë së Motorizuar/Bateria e Mortajave;
- Batalioni III i Këmbësisë/Bateri Kundërajrore/Kompani Xhenio në Mbështetje të Luftimit/Togë e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (CIMIC);
- Batalion Komando;
- Batalion i Operacioneve Speciale/Kompani e Asgjësimit të Municioneve të Rrezikshme (EOD).



b) Kapacitete të mbështetjes

Sasia e përgjithshme e forcave të mbështetjes planëzohet të jetë 5500 vetë dhe do të përbëhet nga:

- Kapacitetet e drejtimit, komandim-kontrollit dhe kapacitete të tjera mbështetëse e ndihmëse për MM dhe SHP të FASH-it;

- Qendra Shëndetësore Rol 2/Spital Ushtarak;

- Qendra e Vëzhgimit Detar;

- Flotilja detare/Qendra e Zhytjeve dhe Shërbimi Hidrografik;

- Regjimenti i Helikopterëve dhe Shërbimi Metrologjik Ushtarak;

- Akademia e Forcave të Armatosura;

- Akademia e Nënoficerëve;

- Shkolla e Trupës;

- Batalioni Logjistik dhe Qendra e Riparimit;

- Batalioni i Kërkim-Shpëtimit (SAR);

- Batalion Ndërlidhje (ASNI);

- SHIU/Agjencia e Inteligjencës;

- Batalion i Policisë Ushtarake (PU);

- Batalioni i mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm dhe Instituti i Gjeografisë Ushtarake (IGJU);

- Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura;

- Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO), Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, (QKKSH), Qendra Ndërminteriale Operacionale Detare (QNOD) dhe Qendra e Vëzhgimit Ajror (QVA).

Konceptet operacionale të FASH-it

A. Forcat e Armatosura

Forcat e Armatosura të RSH-së organizohen dhe funksionojnë si një strukturë e bashkuar forcash me përbërje të forcave tokësore, forcave detare, forcave ajrore dhe forcave mbështetëse. Komandimi dhe kontrolli operacional i FASH-it realizohet përmes një sistemi unik nga Shtabi i Përgjithshëm i FASH-it, me shërbimet që veprojnë si “disponues të forcës”.

FASH zhvillohet, trajnohet, pajiset dhe mbahet në gatishmëri për të përmbushur detyrimet kombëtare, si dhe kërkesat e NATO-s, bazuar në konceptin e një “grupimi të vetëm forcash”.

Përdorimi operacional i FASH-it bëhet i bazuar në konceptin e organizimit të grupeve operacionale për detyrë (*task force*), të cilat ngrihen si një bashkim kapacitetesh ushtarake në përputhje me natyrën e misionit që duhet zgjidhur, më vete ose me NATO-n, BE-në, OKB-në apo koalicione të tjera. Si rregull, grupimet operacionale për detyrë të FA-së organizohen mbi bazën e një batalioni të këmbësorisë, i cili mbështetet dhe përforcohet me kapacitete të tjera nga strukturat e FASH-it.

B. Forcat tokësore

Forcat tokësore përgatisin dhe vënë në dispozicion kapacitete të luftimit tokësor, stërvitin dhe mbajnë në gatishmëri kapacitetet e kërkuara të afta për të planëzuar dhe për të zhvilluar operacione tokësore në mbrojtje të sovranitetit të vendit dhe në përmbushje të detyrimeve në kuadër të aleancës së NATO-s. Forcat tokësore mbështeten në operacion nga të gjitha strukturat e tjera të FASH-it.

Për përmbushjen e kësaj përgjegjësie, forca tokësore përmbush këto detyra kryesore:

- Stërvitjen e të gjitha strukturave të FT-së për përmbushjen e spektrit të plotë të operacioneve tokësore;

- Mbajtjen e nivelit të kërkuar të gatishmërisë së personelit, strukturave dhe të armatimit e të teknikës;

- Vendosja në dispozicion të SHPPFA-së e njësisë të kërkuara për angazhim me rotacione në operacione ushtarake ose joushtarake brenda ose jashtë vendit;

- Sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme për njësitë e angazhuara në operacion, sipas kërkesave të SHPPFA-së.

C. Forcat detare

Forcat detare përgatit, mban në gatishmëri dhe vë në dispozicion kapacitete për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, detyrimet kombëtare në kuadrin e aleancës dhe mbështetjen e autoriteteve civile. Forca detare disponon kapacitete të rëndësishme operacionale dhe mbështetëse të FASH-it. Forcat detare mbajnë në gatishmëri kapacitetet operacionale të kërkuara në funksion të misionit kushtetues të FA-së dhe detyrimeve në funksion të rojës bregdetare.

D. Forcat ajrore

Forca ajrore përgatit, mban në gatishmëri dhe vë në dispozicion kapacitete për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, detyrimet kombëtare në kuadrin e aleancës dhe mbështetjen e autoriteteve civile. Forca ajrore përbën një kapacitet të rëndësishëm operacional dhe mbështetës të FASH-it. Forca ajrore krijon dhe mban në gatishmëri kapacitete operacionale të kërkuara në funksion të misionit kushtetues të FA-së, duke përfshirë dhe policimin ajror.

E. Mbështetja me shërbime të luftimit

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit shërbejnë për të mbështetur me shërbime dhe furnizime operacionet e forcave të luftimit.

F. Komandimi dhe kontrolli

Këto janë kapacitete për komandimin dhe kontrollin në nivel strategjik dhe operativ të operacioneve, që shtrihen nga ato të kohës së paqes deri në ato luftarake, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për të gjitha operacionet aktuale.

G. Logjistika

Këto kapacitete vënë në dispozicion mbështetje për infrastrukturën fikse, si dhe furnizim strategjik dhe shërbime për operacionet. Kjo mbështetje kryhet nëpërmjet parimit të një sistemi të centralizuar logjistik nga lart poshtë.

H. Arsimimi dhe stërvitja

Sistemi i arsimimit dhe i stërvitjes shërben për të mbështetur FA-në me personel të mirëtrajnuar për përmbushjen e gjithë spektrit të detyrave operacionale. Ata kryejnë trajnim të përditësuar të FASH-it, si dhe zhvillojnë bazën konceptuale dhe doktrinale të nevojshme.

I. Mbështetje administrative dhe të tjera

Këto kapacitete sigurojnë mbështetje administrative për FASH-in. Ato përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes së emergjencave civile dhe të përfaqësimit kombëtar në vendet e tjera dhe strukturat ndërkombëtare.

IV.4 Organizimi i forcës së ardhshme të FASH-it

Organizimi i kapaciteteve të identifikuara gjatë procesit të RSM-së në strukturën e ardhshme do të realizohet gradualisht deri në fund të vitit 2015. Ndryshimet në strukturën e forcës do të synojnë si prioritet kapacitetet e luftimit dhe ato që lidhen me mbështetjen e tyre, ndaj elementeve të tjera më pak të rëndësishme.

Disa kapacitete të veçanta, të identifikuara si të papërballueshme nga ky RSM, mbeten të rëndësishme në pikëpamje të zhvillimit të një force kompakte dhe të balancuar. Këto elemente do të konsiderohen gjatë rishikimeve të ardhshme për t'u përfshirë në forcën aktuale. Në periudhën transitorë, këto kapacitete do të mbështeten me burime të kufizuara për të mbijetuar deri në fazën e integritetit të tyre në strukturën e ardhshme.

V. Forca e ardhshme 2020 - gjetje dhe rekomandime

Për zhvillimin e forcës së ardhshme, ky RSM orienton formulimin e planit afatgjatë të zhvillimit të FASH-it (PAZH - 2020) dhe planeve të tjera mbështetëse, të cilat të mbajnë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e mëposhtme:



- Kërcënimet dhe rreziqet që pritet të dominojnë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme në mjedisin e sigurisë së Shqipërisë, të rajonit tonë dhe në nivel global, pritet të jenë ato që vijnë nga grupimet brenda shteteve, nga aktorët joshitetërorë, nga faktorët natyrorë, industrialë dhe njerëzorë, si dhe ato nga sfidat në zhvillim ndaj sigurisë kolektive.

- Si vend anëtar i NATO-s dhe që synon anëtarësimin në BE, siguria dhe mbrojtja e RSH-së janë dhe do të vazhdojnë të jenë pjesë e mekanizmave të sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive, me përfitimet dhe kontributet përkatëse.

- Duke marrë parasysh sa më sipër dhe duke konsideruar faktin që FASH kanë tre objektiva themelore ushtarakë: mbrojtjen e sovranitetit, pavarësisë dhe territoreve të vendit nga jashtë; mbrojtjen dhe mbështetjen e popullit shqiptar; mbështetjen e paqes dhe sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

- Forcat e Armatosura do të marrin pjesë në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, ku sipas misionit të tyre kushtetues, në bashkëpunim me institucionet e tjera të sigurisë, ato mund të kenë rol kryesor, rol mbështetës apo rol kontribues.

Rekomandimet e RS-së

1. Forca e ardhshme do të jetë një forcë më e motivuar, pajisur dhe trajnuar për të vepruar në të gjithë spektrin e detyrave të misionit, nga skenarët luftarakë të nenit 5, deri tek ato në mbështetje të paqes, brenda dhe jashtë vendit, më vete ose me aleatët, kryesisht një forcë e këmbësorisë me elemente të këmbësorisë së motorizuar.

2. Prioritet të parë në planin e zbatimit të kapaciteteve do t'i jepet batalionit të këmbësorisë së motorizuar (MotInfBat) dhe elementeve të tij shoqëruese të mbështetjes së luftimit dhe të elementeve të mbështetjes me shërbime. Prioriteti i dytë do të vihet në ngritjen e grupit tokësor të detyrës së operacioneve speciale (SOLTG) dhe elementeve të tij shoqëruese të mbështetjes së luftimit dhe të elementeve të mbështetjes me shërbime. Mbajtja e gatishmërisë luftarake në gjithë FASH-in është një kërkesë themelore gjatë gjithë këtij tranzicioni.

3. Madhësia e forcës së ardhshme të jetë 8500 vetë, objektiv që rekomandohet të realizohet deri në vitin 2015.

4. Për kalimin nga forca aktuale me personel prej 10.190 në forcën e ardhshme me personel prej 8500, të hartohet një plan i detajuar i zbatimit. Ky plan të përputhet në vija të përgjithshme me nivelet e mëposhtme të pritshmërisë së madhësisë së personelit gjatë periudhës trevjeçare:

- Viti 2013 - Madhësia e forcës do të shkojë në një personel prej 9600.

- Viti 2014 - Madhësia e forcës do të shkojë në një personel prej 9000.

- Viti 2015 - Madhësia e forcës do të shkojë në një personel prej 8500.

5. Me qëllim që të sigurohet personel i motivuar, i mirëtrajnuar dhe i mirëpajisur me pajisje moderne dhe të mirëmbajtura, shpenzimet e alokuara me kapacitetet e nevojshme operacionale rekomandohet që të synojnë raportet 35 % - personeli, 35 % - O&M dhe 30 % - investimet.

6. Shpenzimet e alokuara për mbrojtjen në periudhën afatmesme plotësojnë nevojat e zhvillimit të kapaciteteve kryesore të FASH-it. Për të plotësuar të gjitha kërkesat e kapaciteteve, buxheti i mbrojtjes duhet të jetë jo më pak se rreth 1,3 deri 1,5% të GDP-së, në vartësi të performancës ekonomike të vendit, me qëllim përshpejtimin e procesit të zhvillimit të forcës së ardhshme.

7. Për të realizuar arritjen e madhësisë së forcës prej 8500 vetash, Ministria e Mbrojtjes do të organizojë Forcat e Armatosura në një strukturë të re organizative.


8. Plan i zbatimit të gjetjeve të RSM-së do të jetë gati në maj 2013. Ai do të parashikojë edhe amendimet ligjore/nënligjore përkatëse të kuadrit ligjor ekzistues në planin afatmesëm.

9. Gjetjet e RSM do të reflektohen në dokumentin e radhës të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, të Strategjisë Ushtarake, në direktivën e mbrojtjes dhe në planin afatgjatë të zhvillimit të FASH-it.

10. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes rekomandohet të kryhet në mënyrë periodike në periudha kohore 4-5-vjeçare, në vartësi nga qëndrueshmëria e pritjeve/supozimeve të vlerësuara në këtë rishikim për periudhën afatmesme.

SHTOJCAT E RSM 2012 TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Shtojca 1.



Shtojca 1: Skema principale e zhvillimit të RSM 2012



Shtojca 2.

LISTA E SKENARËVE TË PLANIFIKIMIT TË RSH	
SKENARË KU MM/FASH KANË ROL DREJTUES	
	■ Cënimi i Integritetit Territorial/ Sovranitetit
	■ Situata 'Renegade'
	■ Dhënie e Ndhmës në Rast Fatkeqësie
	■ Vendosje e Paqes
	■ Shpërthim i Municioneve të Tepërta
SKENARË KU MINISTRIA E BRENDSHME KA ROL DREJTUES	
	■ Mbrojtje e Rendit Kushtetues
	■ Sulm Terrorist
	■ Zhvendosje Masive e Njerëzve/ Refugjatëve
	■ Kontrabandë Detare
SKENARË KU MINISTRI TË TJERA KANË ROL DREJTUES	
	■ Tërmet
	■ Mot Ekstrem
	■ Aksident Industrial
	■ Aksident Transporti me Përmasa të Mëdha

Shtojca 3

Rolet dhe Misionet e Institucioneve të Sigurisë së RSH (Në Kohë Luftë)

Rolet dhe Misionet/ Institucionet	Z K M	M M	M P J	M B	M D	MF	M T P P T	SH I SH	M SH	M E T E	M B U M K	M M P A U	M O E I	M I T I K	K S K
Grumbullon, analizon, dhe shpërndan informacion për sigurinë kombëtare		M	M	M	M	M	M		M	M	M	M		M	
Kryen vlerësime strategjike të sigurisë në nivel kombëtar		M		M		M	M	M	M	M					M
Formulon/përditëson zhvillime të politikave strategjike		M	M	M	M	M	M	M	M	M	M				
Përditëson dhe zbaton planet e operacioneve			M	M	M	M	M	M	M	M	M				
Garanton integritetin (tokësor, ajror, detar) dhe pavarësinë e vendit			M	M			M	M	M			M			
Mban rezerva të mallrave të ndryshme		M				M	M		M	M	M				
Mban rezerva financiare për përballimin e situatave të papritura		M		M			M								



Siguron komandim kontroll të vazhdueshëm dhe të qartë për institucionet që kanë përgjegjësi për sigurinë e vendit		M		M										M	
Vë në dispozicion kapacitete ushtarake për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë				M		M	M						M		
Vë në dispozicion kapacitete jo-ushtarake për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë		M		M		M	M	M	M	M					
Zhvillon dhe mban në funksionim infrastrukturat kritike të transportit		M				M				M				M	
Zhvillon dhe mban në funksionim infrastrukturat kritike të komunikimit		M				M				M					
Zhvillon dhe mban në funksionim infrastrukturat kritike të energjisë				M		M	M								
Identifikon infrastrukturat kritike për tu mbrojtur në kohë lufte				M		M	M	M	M			M		M	
Kryen mbrojtjen e		M					M							M	

infrastrukturave kritike															
Rivendos funksionimin e infrastrukturave kritike		M					M	M		M				M	
Zhvillon legjislacionin qe lidhet me mbrojtjen		M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	
Avancon interesat kombëtare nëpërmjet mjeteve diplomatike		M		M	M		M		M	M			M		
Zhvillon dhe zbaton strategji, politika dhe procedura të mbrojtjes		M	M	M	M	M	M	M					M		
Zhvillon dhe zbaton strategji, politika dhe procedura ekonomike (që kanë lidhje me mbrojtjen)			M			M	M				M		M	M	
Zhvillon dhe zbaton strategji, politika dhe procedura mjedisore (që kanë lidhje me mbrojtjen)		M	M	M		M	M	M	M	M			M		
Zhvillon dhe zbaton strategji, politika dhe procedura të informacionit (që kanë lidhje me mbrojtjen)	M		M	M									M	M	
Vë në dispozicion produkte të kundër-		M	M	M			M								



inteligjencës															
Mban rendin publik		M			M										
Kryen Operacione të Emergjencave Civile		M				M	M		M	M		M		M	
Kryen operacione të lehtësimit të pasojave në rast fatkeqësish natyrore e industriale brenda vendit		M	M			M	M	M	M			M			
Kryen operacione të kërkim-shpëtimit ajror (SAR)		M	M	M		M		M	M			M			
Kryen operacione të kërkim-shpëtimit detar (SAR)			M	M											
Siguron funksionimin normal të shërbimeve kryesore	M		M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	

Shënim:

- Me ngjyrë të kuqe shprehen institucionet që kanë rol drejtues (D)
- Me ngjyrë të verdhë janë institucionet që kanë rol mbështetës (M)
- Me ngjyrë të gjelbër shprehen institucionet që kanë rol koordinues (K)

Shtojca 4

Tabela e mundësisë së ndodhjes së njëkohshme të skenarëve dhe krahasimit të tyre

Mundësia e ndodhjes në të njëjtën kohë të skenarëve	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5	Vërejtje
<u>Skenari 1</u> Cenimi i sovranitetit			X			
<u>Skenari 2</u> Rast Renegade						
<u>Skenari 3</u> Dhënie ndihme në raste fatkeqësie	X					
<u>Skenari 4</u> Vendosja e paqes	X	X	X	X	X	Forcat e dislokueshme do të numërohen vetëm për operacione të drejtuara nga Aleanca dhe jo për operacione brenda vendit
<u>Skenari 5</u> Mbrojtje e Rendit kushtetues			X			
<u>Skenari 6</u> Sulm terrorist			X			



Skenari 7 Zhvendosje masive refugjatësh				X		
Skenari 8 Kontrabandë detare			X	X		Kontrabanda detare rritet gjatë krizave të tjera.
Skenari 9 Shpërthim i municioneve të tepërta			X	X		
Skenari 10 Tërmet				X		
Skenari 11 Mot ekstrem		X				
Skenari 12 Aksident industrial				X		
Skenari 13 Aksident transporti me përmasa të mëdha					X	

Shtojca 5

Tabela e vlerësimit të prioritetit të skenarëve

Grupet e prioriteteve	Prioriteti 1	Prioriteti 2	Prioriteti 3
<u>Skenari 1</u> Cënimi i sovranitetit	X		
<u>Skenari 2</u> Renegade		X	
<u>Skenari 3</u> Dhënie ndihme në raste fatkeqësie			X
<u>Skenari 4</u> Vendosja e paqes	X		
<u>Skenari 5</u> Mbrojtje e rendit kushtetues		X	
<u>Skenari 6</u> Sulm terrorist			X
<u>Skenari 7</u> Zhvendosje masive refugjatësh			
<u>Skenari 8</u> Kontrabandë detare	X		
<u>Skenari 9</u> Shpërthim i municioneve të tepërta	X		
<u>Skenari 10</u> Tërmet	X		
<u>Skenari 11</u> Mot ekstrem	X		
<u>Skenari 12</u> Aksident industrial			X
<u>Skenari 13</u> Aksident transporti dhe përmasa të mëdha			X



Shtojca 6

Abbreviation and Acronyms

RSM	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes
RSH	Republika e Shqipërisë
FASH	Forcat e Armatosura të Shqipërisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
BE	Bashkimi European
NDPP	Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes në NATO
CSDP	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE
WMD	Armët e Shkatërrimit në Masë
CT	Objektivat e kapaciteteve
LoA	Niveli i Ambicies
CD	Mbrojtja Kolektive
NA5CRO	Operacionet në Përgjigje të Krizave jashtë nenit 5
STANAG	Marrëveshje Standardizimi të Aleancës
GDP	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
O&M	Operacionet dhe Mirëmbajtja
ALL	Lek Shqiptar
CBP	Planifikimi i Bazuar në Kapacitete
CBRN	Kimik, Bakteriologjik, Radiologjik dhe Bërthamor
GS HQ	Shtabi i Përgjithshëm
CISA	Ajencia e Sistemit të Komunikim-Informimit
MGI	Instituti i Gjeografisë Ushtarake
JOC	Qendra e Bashkuar Operacionale
SARNC	Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit
QNOD	Qendra Ndërminteriale Operacionale Detare
NCSO	Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes
ASC	Qendra e Vëzhgimit Ajror
LF	Forca Tokësore
MF	Forca Detare
AF	Forca Ajrore
LTDP	Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FASH-it
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SU	Strategjia Kombëtare Ushtarake
ZKM	Zyra e Kryeministrit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MTPPT	Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MITIK	Ministria e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit
KSK	Këshilli i Sigurisë Kombëtare
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror

VENDIM
Nr. 270, datë 3.4.2013

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË
KUVAJTIT PËR SHËRBIMIN AJROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për shërbimin ajror, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MARRËVESHJE PËR SHËRBIMIN AJROR
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Kuvajtit, më poshtë të quajtura Palët Kontraktuese,

Duke dëshiruar të nxisin zhvillimin e shërbimit ajror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Kuvajtit dhe të inkurajojnë në masën më të madhe të mundshme bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë,

Duke dëshiruar të zbatojnë për këto shërbime parimet dhe dispozitat e Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe Marrëveshjes Transit për Shërbimet Ndërkombëtare Ajrore, të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
PËRKUFIZIME

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, nëse teksti nuk kërkon ndryshe:

- a) "**Konventa**" do të thotë Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944, dhe përfshin çdo shtojcë të miratuar në bazë të Nenit 90 të kësaj Konvente dhe çdo ndryshim të Shtojcave apo Konventës sipas Neneve 90 dhe 94, për sa kohë që këto Shtojca dhe ndryshime miratohen nga të dyja Palët Kontraktuese;
- b) "**Marrëveshja**" do të thotë kjo Marrëveshje, Shtojca bashkëlidhur, si dhe çdo ndryshim i bërë në Marrëveshje apo Shtojcë;
- c) "**Autoritetet Aeronautike**" do të thotë në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, në personin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në rastin e Shtetit të Kuvajtit, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil ose në të dyja rastet çdo person apo agjenci tjetër e autorizuar për të kryer funksionet e ushtruara aktualisht nga autoritetet e lartpërmendura;
- d) "**Shoqëria Ajrore e Caktuar**" do të thotë çdo shoqëri ajrore që Pala Kontraktuese ka caktuar me shkrim tek Pala tjetër Kontraktuese, në pajtim me Nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, si një shoqëri ajrore që do të kryejë shërbimin ajror për të cilin është rënë dakord në itineraret e specifikuar në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
- e) "**Territori**" "**Shërbim Ajror**" "**Shërbim Ajror Ndërkombëtar**" "**Ndalesë për Qëllim jo Trafiku**" dhe "**Shoqëri Ajrore**" për qëllim të kësaj Marrëveshjeje do të kenë kuptimin e përcaktuar në Nenin 2 dhe 96 të Konventës;
- f) "**Kapacitet**" do të thotë: -

- I) në lidhje me një avion, ngarkesa me pasagjerë dhe ngarkesa e këtij avioni e disponueshme në një itinerar apo pjesë të një itinerari.
- II) në lidhje me një shërbim ajror specifik, kapaciteti i avionit të përdorur për një shërbim të tillë, shumëzuar me shpeshtësinë e operuar nga një avion i tillë gjatë një periudhe të caktuar në një itinerar apo pjesë të një itinerari.
- g) **"Tarifë"** do të thotë çmimet që duhet të paguhet për transportin e pasagjerëve, bagazheve dhe mallrave dhe kushtet në të cilat zbatohen këto çmime, duke përfshirë çmimet dhe kushtet për agjencinë dhe shërbime të tjera ndihmëse por duke përjashtuar pagesat dhe kushtet për transportin e postës;
- h) **"Shtojcë"** do të thotë kalendari i itinerareve që gjendet në shtojcën e kësaj Marrëveshje apo e ndryshuar në përputhje me dispozitat e paragrafit (3) të Nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje. Shtojca përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha referencat tek Marrëveshja përfshijnë edhe referencën tek Shtojca, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje.
- i) **"Pagesa e përdoruesit"** do të thotë pagesa që i ngarkohet shoqërive ajrore për ofrimin e aeroportit, pronat apo ambientet e navigimit ajror apo të sigurisë së aviacionit.
- j) **"Shërbimet e rëna dakord"** do të thotë shërbime ajrore të planifikuara në itineraret e specifikuar në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje për transportin e pasagjerëve, ngarkesave dhe postës në pajtim me të drejtat e rëna dakord për kapacitetin.

Neni 2

DHËNIA E TË DREJTAVE DHE PRIVILEGJEVE

- 1) Secila Palë Kontraktuese i jep Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e specifikuar në këtë Marrëveshje për të bërë të mundur që shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuara prej saj të krijojnë dhe kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare në itineraret e përcaktuar në seksionin përkatës të Shtojcës së saj (më poshtë të quajtura përkatësisht **"SHËRBIMET E RËNA DAKORD"** dhe **"ITINERARET E SPECIFIKUAR"**).
- 2) Sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ndërsa kryejnë një shërbim të rënë dakord në një itinerar të specifikuar, shoqëria ose shoqëritë ajrore e/të caktuar(a) e/të secilës Palë Kontraktuese gëzon/jnë privilegjet e mëposhtme:
 - a) të fluturojë/në pa u ulur përgjatë territorit të Palës tjetër Kontraktuese,
 - b) të kryejë/në ndalesa në këtë territor jo për qëllime trafiku, dhe
 - c) të kryejë/në ndalesa në këtë territor në pikën apo pikat e specifikuar për këtë itinerar në Shtojcë, me qëllim shkarkimin dhe angazhimin e trafikut ndërkombëtar me pasagjerë, postë dhe ngarkesë.
- 3) Shoqëritë ajrore të secilës Palë Kontraktuese, përveç atyre të përcaktuara sipas nenit (3) të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë gjithashtu të drejtat e përcaktuara në paragrafët 2(a) dhe 2 (b) të këtij neni.
- 4) Asgjë në paragrafin 1 të këtij Neni nuk konsiderohet se i jep shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuar(a) të një prej Palëve Kontraktuese, të drejtën për të marrë pasagjerë, ngarkesë dhe



postë me shpërblim apo kontraktim dhe për t'i destinuar ato në një vend tjetër në territorin e asaj Pale tjetër Kontraktuese.

Neni 3

CAKTIMI DHE AUTORIZIMI

- 1) Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të caktojë me shkrim tek Pala tjetër Kontraktuese një shoqëri apo më shumë shoqëri ajrore, me qëllim kryerjen e shërbimeve të rëna dakort, në përputhje me këtë marrëveshje dhe të tërheqë ose ndryshojë një caktim të tillë.
- 2) Me marrjen e një caktimi të tillë dhe të aplikimit nga shoqëria ajrore, në formën dhe mënyrën e përshkruar për autorizimet e operimit dhe lejen teknike, secila Palë Kontraktuese lëshon autorizimin e përshtatshëm të operimit me vonesat minimale proceduriale për të ushtuar të drejtat e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, me kusht që:
 - a. Shoqëria ajrore ka vendin kryesor të biznesit në territorin e Palës Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore. Dhe; ka dhe ruan kontrol e efektshëm rregullator të shoqërisë ajrore dhe mban një Çertifikatë të vlefshme të Operatorit Ajror (AOC) të lëshuar nga Palët Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore.
 - b. Pala Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore është në përputhje me dispozitat e vendosura në nenin 14 dhe 15; dhe
 - c. Shoqëria ajrore e caktuar është e kualifikuar për të përmbushur kushte të tjera të parashikuara sipas ligjeve dhe rregullave që zbatohen normalisht në operimin e shërbimeve të transportit ajror ndërkombëtar, nga Pala Kontraktuese e cila merr caktimin.
- 3) Me marrjen e autorizimit të operimit të paragrafit (2), një shoqëri ajrore mund në çdo kohë të fillojë të operojë shërbimet e rëna dakort për të cilat është e caktuar, me kusht që shoqëria ajrore të përmbush dispozitat e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

TERHEQJA, REVOKIMI, PEZULLIMI, KUFIZIMI DHE VENDOSJA E KUSHTEVE

- 1) Autoritetet Aeronautike të seciles Pale Kontraktuese kanë të drejtën të tërheqin autorizimet e permendura në paragrafin (1) të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një shoqëri ajrore të caktuar nga Pala tjetër Kontraktuese, dhe të revokojnë, pezullojnë, kufizojnë ose të vendosin kushte mbi autorizime të tilla, perkohesisht ose perhere kur:
 - a) Shoqëria ajrore nuk arrin të ruajë vendin e saj kryesor të biznesit në territorin e Palës Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore. Dhe; të vazhdojë të ruajë kontrollin e efektshëm rregullator të shoqërisë ajrore dhe të mbajë një Certifikatë të vlefshme të Operatorit Ajror të lëshuar nga Pala Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore.
 - b) Pala Kontraktuese që cakton shoqërinë ajrore deshton të përmbushë dispozitat e vendosura në nenin 14 dhe nenin 15; dhe
 - c) Shoqëria ajrore e tillë nuk është e kualifikuar të përmbushë kushtet e parashikuara sipas ligjeve dhe rregullave që zbatohen normalisht për operimin e shërbimeve ndërkombëtare ajrore nga Pala Kontraktuese e cila merr caktimin.

2. Përveç kur veprimi i menjëhershëm është thelbësor për të parandaluar shkeljen e ligjeve dhe rregullave të parashikuara më sipër ose përveçse kur siguria kërkon të ndërmerren veprime në pajtim me dispozitat e Nenit 14 ose Nenin 15, të drejtat e renditura në paragrafin (1) të këtij Neni ushtrohen vetëm pas konsultimeve ndërmjet autoriteteve aeronautike, në pajtim me Nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

PAGESAT PËR PËRDORIMIN E AEROPORTEVE DHE AMBIENTEVE

Secila prej Palëve Kontraktuese mund të vendosë dhe/ose të lejojë që të vendosen pagesa të drejta dhe të arsyeshme për përdorimin aeroporteve dhe ambienteve të tjera nën kontrollin e saj.

Pagesat e vendosura në territorin e secilës Palë Kontraktuese për përdorimin e aeroporteve dhe ambienteve të tjera të aviacionit në ngarkim të avionit të shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuara nga Pala tjetër Kontraktuese nuk mund të jenë më të larta se ato të vendosura në ngarkim të avionëve të shoqërisë ose shoqërive ajrore kombëtare që janë të angazhuara në shërbime të ngjashme ajrore ndërkombëtare.

Neni 6

PËRJASHTIMET NGA DETYRIMET DOGANORE DHE DETYRIME TË TJERA

- 1) Avioni që përdoret në shërbime ajrore ndërkombëtare nga shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuara nga njëra Palë Kontraktuese, si dhe pajisjet e tyre të zakonshme, pjesë këmbimi, ngarkesa me karburant dhe lubrifikantë dhe depot e avionit (përfshirë, ushqimet pijet dhe duhani) në bord, ky avion përjashtohet mbi bazën e reciprocitetit nga detyrimet e importit përfshirë këtu tarifën doganore, akcizën, TVSH, taksa dhe tatime të tjera që paguhet në import, tarifat e inspektimit dhe detyrime apo taksa të tjera në momentin e mbërritjes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, me kusht që pajisje dhe ngarkesa të tilla të mbeten në bordin e avionit deri në kohën kur ato ri-eksportohen.
- 2) Ngarkesa me karburante, pjesë këmbimi, pajisje të zakonshme dhe depot a avionit të futura në territorin e secilës prej Palëve Kontraktuese apo në emër dhe për llogari të shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuara të Palës Kontraktuese apo të marra në bord të avionit të përdorur nga kjo ose këto shoqëri ajrore të caktuara, me qëllim vetëm për t'u përdorur në kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare, do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet dhe pagesat kombëtare, përfshirë detyrimet tatimore dhe tarifat e inspektimit të vendosura në territorin e Palës së parë Kontraktuese, edhe kur këto furnizime duhet të përdoren në pjesë të udhëtimit të kryer nëpër territorin e Palës Kontraktuese ku ato merren në bord. Materialet e përmendura më lart mund të kërkojnë të mbahen nën mbikëqyrjen apo kontrollin e doganave.
- 3) Pajisjet e zakonshme, pjesët e këmbimit, depot e avionit, dhe ngarkesat me lubrifikantë të transportuara në rrugë ajrore të cilat mbahen në bordin e anijes të çdonjërit prej Palëve Kontraktuese mund të shkarkohen në territorin e cilësdo Pale Kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të Palës Kontraktuese, e cila lejohet të kërkojë që këto materiale të vendosen nën mbikëqyrjen e tyre deri në kohën kur ato re ri-eksportohen apo ndryshe disponohen në përputhje me rregullat doganore.



- 4) Sendet e luajtshme të shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuara nga një Palë Kontraktuese si pajisje zyrash, materiale pune në zyra, dokumente udhëtimi, përfshirë bileta të linjës ajrore, fatura të linjave ajrore, si dhe materiale reklamuese dhe artikuj për shpërndarje, të futura në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga detyrimet e importit përfshirë këtu tarifën doganore, akcizën, TVSH, tarifën e inspektimit dhe detyrime apo taksa të tjera që paguhen në import.

Neni 7

DISPOZITA FINANCIARE

Secila Palë Kontraktuese ndërmerr që t'i japë shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuar(a) të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën e transferimit falas, në normën zyrtare të këmbimit, të tepricës së të ardhurave mbi shpenzimet e realizuara në territorin e saj në lidhje me transportin e pasagjerëve, bagazheve, transfertave postare dhe mallrave nga shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuar(a) nga Pala tjetër Kontraktuese. Në të gjitha rastet kur sistemi i pagesës ndërmjet Palëve Kontraktuese rregullohet nga një marrëveshje e veçantë, ajo marrëveshje do të zbatohet.

Neni 8

PËRFAQËSIMI TEKNIK DHE TREGTAR

1. Shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuar(a) nga një Palë Kontraktuese ka të drejtë të ruajë përfaqësimin e vet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.
2. Shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuar(a) nga një Pale Kontraktuese, i lejohet, në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës tjetër në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin, të sjellë dhe mbajë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, staf menaxhues shitjesh, teknik, operacional dhe staf tjetër specialistësh që i nevojitet për shërbimet ajrore.
3. Në rastin e caktimit të një agjenti të përgjithshëm apo të një agjenti të përgjithshëm shitjesh, ky agent caktohet në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse të zbatueshme të secilës Pale Kontraktuese.
4. Në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare të zbatueshme në secilën Palë Kontraktuese, çdo shoqëri ajrore e caktuar ka të drejtë të angazhohet për shitjen e shërbimit të transportit ajror në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet agjentit të saj dhe çdo person do të ketë mundësi të blejë këtë lloj shërbimi transporti.

Neni 9

NORMAT E HYRJES DHE VERIFIKIMIT

- 1) Ligjet, rregullat dhe normat në fuqi në një prej Palëve Kontraktuese në lidhje me hyrjen apo nisjen nga territori i saj i pasagjerëve, ekuipazhit, ngarkesës dhe postes së avionit (si për shembull rregullat në lidhje me hyrjen, verifikimin, emigrimin, pasaportat, doganat, dhe karantinën) janë të zbatueshme për pasagjerët, ekuipazhin, ngarkesën dhe postën e avionit të një shoqërie ajrore të caktuar nga Pala tjetër Kontraktuese ndërsa ajo ndodhet në territorin e Palës së parë Kontraktuese.
- 2) Ligjet dhe normat e një Pale Kontraktuese në lidhje me pranimin, qëndrimin apo largimin nga territori i saj të avionëve të angazhuar në navigimin ajror ndërkombëtar apo me

operimin dhe navigimin e një avioni të tillë kur ai ndodhet në territorin e tij, zbatohen për avionët e të dyja Palëve Kontraktuese pa dallim për sa i përket shtetësisë, dhe duhen respektuar nga avionë të tillë me hyrjen apo largimin nga andej apo kur janë brenda territorit të Palës Kontraktuese.

- 3) Pasagjerët, bagazhet, ngarkesa dhe posta në transit përgjatë territorit të një Pale Kontraktuese janë objekt i një forme të thjeshtuar kontrolli doganor dhe/ose kontrolli të emigracionit. Bagazhet, ngarkesa dhe posta përjashtohen nga detyrimet doganore, tarifat e inspektimit dhe detyrime dhe pagesa të tjera kombëtare nëse janë në transit të drejtpërdrejtë.

Neni 10

DISPOZITA MBI KAPACITETET

- 1) Do të ketë mundësi të drejtë dhe të barabartë për shoqërinë ose shoqëritë ajrore të caktuar(a) të secilës Palë Kontraktuese për të kryer shërbimet e rëna dakord në çfarëdo itinerari të specifikuar në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje ndërmjet territoreve të tyre përkatëse.
- 2) Gjatë kryerjes së shërbimeve të rëna dakord në itineraret e specifikuar në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, shoqëria ose shoqëritë ajrore e/të caktuar(a) të cilësdo Pale Kontraktuese merr parasysh interesin e shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuar(a) të Palës tjetër Kontraktuese, në mënyrë që të mos ndikojë padrejtësisht tek shërbimet ajrore që shoqëria ajrore e fundit kryen në të gjitha itineraret apo pjesë të tyre.
- 3) Shërbimet e rëna dakord të ofruara nga shoqëria ajrore e caktuar ruajnë si objektiv parësor ofrimin, në një faktor të arsyeshëm ngarkese, të kapaciteteve të përshtatshme për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të parashikuara në mënyrë të arsyeshme për transport të pasagjerëve, postës dhe ngarkesës, që kanë orgjinë apo destinacion territorin e Palës Kontraktuese që ka caktuar shoqërinë ajrore. E drejta e shoqërisë ose shoqërive ajrore të caktuar(a) të cilësdo Palë Kontraktuese për të marrë në bord apo zbritur në vendin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese trafik ndërkombëtar të destinuar për apo që vjen nga vende të treta duhet të jenë në përputhje me parimet se ky trafik do të jetë me natyrë plotësuese dhe kapaciteti duhet të jetë i lidhur me:
 - a) nevojat e trafikut ndërmjet territorit të Palës Kontraktuese që ka caktuar shoqërinë ose shoqëritë ajrore dhe vendeve në itineraret e specifikuar;
 - b) kërkesat e trafikut të zonave përmes të cilave kalon linja ajrore, pasi janë marrë parasysh shërbime të tjera ajrore të operuara nga shoqëri ajrore të shteteve që përbëjnë zonën, dhe
 - c) kërkesat e linjës ajrore përgjatë operimit.

Neni 11

MIRATIMI I KALENDARËVE TË FLUTURIMEVE

- 1) Shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuara komunikojnë me Autoritetet Aeronautike të Palëve Kontraktuese jo më vonë se tridhjetë ditë përpara nisjes së shërbimeve për të cilat është rënë dakord në itineraret e specifikuar në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, llojin e shërbimit, llojet e avionëve që do të përdoren dhe kalendarët e fluturimeve. Kjo në të njëjtën mënyrë zbatohet për ndryshime e mëvonshme si dhe përpara çdo kalendar veror dhe dimëror.



- 2) Autoritetet Aeronautike që marrin në dorëzim këtë kalendar fluturimesh normalisht aprovojnë kalendarët apo sugjerojnë modifikime në to. Në çdo rast, shoqëria ose shoqëritë ajrore të caktuara nuk i fillojnë shërbimet e tyre përpara miratimit të kalendarëve nga Autoritetet Aeronautike përkatëse. Kjo dispozitë zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe për ndryshime të mëvonshme.

Neni 12 INFORMACIONE DHE STATISTIKA

Autoritetet Aeronautike të secilës Palë Kontraktuese duhet t'i paraqesin Autoriteteve Aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, me kërkesë të tyre, të dhëna periodike apo të dhëna të tjera statistikore siç mund të jetë nevojshme në mënyrë të arsyeshme, me qëllim rishikimin e kapacitetit të ofruar nga shoqëria ose shoqëritë ajrore e/të caktuar(a) nga Pala e parë Kontraktuese në itineraret e specifikuar në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Këto të dhëna përfshijnë informacionin e kërkuar për të përcaktuar sasinë e trafikut të kryer.

Neni 13 VENDOSJA E TARIFAVE

- 1) Tarifat e çfarëdolloj shërbimi të rënë dakord vendosen në nivele të arsyeshme, duke i kushtuar vëmendje të duhur të gjithë faktorëve të rëndësishëm, përfshirë shpenzimet e operimit, fitimin e arsyeshëm, karakteristika të shërbimit apo në itineraret e ndryshueshëm (si standardet e shpejtësisë dhe akomodimit) dhe tarifat e linjave të tjera ajrore për çfarëdolloj pjese të itinerarit të specifikuar, këto tarifa duhet të përcaktohen në përputhje me dispozitat e mëposhtme të këtij neni.
- 2) Në lidhje me tarifat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, nëse është e mundur, bihet dakord për sa i përket secilës prej itinerareve të specifikuara ndërmjet shoqërive ajrore të caktuara në fjalë në konsultim, kur është e nevojshme me shoqëri të tjera ajrore që operojnë në të gjithë apo një pjesë të këtij itinerari. Tarifat e rëna dakord në këtë mënyrë duhet të aprovohen nga Autoritetet Aeronautike të paktën nentëdhjetë (90) ditë përpara datës së propozuar për paraqitjen e këtyre tarifave. Kjo periudhë mund të shkurtohet në raste të veçanta me marrëveshje me Autoritetet përkatëse të Aeronautikës.
- 3) Nëse shoqëritë ajrore të caktuara nuk mund të bien dakord mbi asnjë prej këtyre tarifave apo nëse për disa arsye nuk mund të bihet dakord mbi një tarifë në përputhje me dispozitat e paragrafit (2) të këtij Neni, Autoritetet e Aeronautikës të Palëve Kontraktuese duhet të përpiqen ta përcaktojnë atë me marrëveshje ndërmjet njëri tjetrit.
- 4) Nëse Autoritetet Aeronautike nuk mund të bien dakord për miratimin e asnjë tarife të paraqitur atyre në bazë të paragrafit (2) të këtij Neni ose në përcaktimin e çfarëdo tarife sipas paragrafit (3), çështja i referohet Palëve Kontraktuese për t'u zgjidhur në përputhje me dispozitat e Nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje.
- 5) Në pritje të përcaktimit të tarifave në përputhje me dispozitat e këtij Neni, tarifat tashmë në fuqi do të kenë përparësi. Megjithatë, një tarifë nuk do të zgjatet në bazë të këtij paragrafi për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj pas datës në të cilën ajo do të kishte skaduar.

Neni 14
SIGURIA E AVIACIONIT

- 1) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë në çdo zonë mbi ekuipazhin ajror, avionët apo operimin e tyre, të miratuara nga ana e Palës tjetër Kontraktuese. Ky konsultim zhvillohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga kjo kërkesë.
- 2) Nëse pas këtyre konsultimeve, njëra Palë Kontraktuese konstaton se Pala tjetër Kontraktuese nuk mban dhe administron në mënyrë efektive standardet e sigurisë në çfarëdolloj zone të tillë, që janë të paktën të barabarta me standardet minimale të përcaktuara në atë kohë sipas Konventës, Pala e parë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese në lidhje me këto konstatime, si dhe hapat që konsiderohen të nevojshme në përputhje me ato standarde minimale dhe që Pala tjetër Kontraktuese të marrë masat e duhura korrigjuese. Pamundësia nga Pala tjetër Kontraktuese për të marrë masa të përshtatshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve apo një periudhe më të gjatë që mund të bihet dakord, do të përbëjë shkak për zbatimin e Nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje.
- 3) Pavarësisht detyrimeve të përmendura në Nenin 33 të Konventës, është rënë dakord se çfarëdo avioni i operuar nga shoqëritë ajrore të njëres prej Palëve Kontraktuese për shërbime për në apo nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, kur ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese mund të bëhet objekt i hetimit nga përfaqësues të autorizuar të Palës tjetër Kontraktuese, në bord dhe rreth avionit, për të kontrolluar si vlefshmërinë e dokumenteve të tij dhe ato të anëtarëve të tij të ekuipazhit dhe kushtet e dukshme të avionit dhe pajisjeve të tij (në këtë nen të quajtur "inspektim të avionit dhe personelit"), me kusht që kjo të mos sjellë vonesa të paarsyeshme.
- 4) Nëse një "inspektim i avionit dhe personelit" apo një sërë inspektimesh të tilla shkaktojnë lindjen e:
 - a) shqetësimeve serioze që një avion apo operimi i një avioni nuk respekton standardet minimale të përcaktuara në atë kohë sipas Konventës, ose
 - b) shqetësimeve serioze se ka një mungesë të mirëmbajtjes së efektshme dhe administrimit të standardeve të sigurisë të përcaktuar në atë kohë sipas Konventës.

Pala Kontraktuese që kryen një inspektim, për qëllime të Nenit 33 të Konventës, është e lirë të konkludojë se kërkesat sipas të cilave certifikata apo licenca për sa i përket këtij avioni apo ekuipazhit të këtij avioni, janë lëshuar dhe janë bërë të vlefshme apo kërkesat sipas të cilave ky avion operohet, nuk janë të barabarta apo më të larta se standardet minimale të përcaktuara në bazë të Konventës.

- 5) Në rast se nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë ajrore, mohohet hyrja për qëllim të kryerjes së një "inspektimi të avionit dhe personelit" të një avioni të operuar nga ajo shoqëri ose shoqëritë ajrore e një prej Palëve Kontraktuese në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Pala tjetër Kontraktuese është e lirë të konkludojë se ngrihen shqetësime serioze të tipit të përmendur në paragrafin 4 më lart të këtij Neni dhe të nxjerrë konkluzionet e përmendura në këtë paragraf.



- 6) Secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën për të pezulluar apo ndryshuar autorizimin e operimit të një shoqërie ajrore të Palës tjetër Kontraktuese menjëherë, në rast se Pala e parë Kontraktuese konkludon se si rezultat i një “inspektimi të avionit dhe personelit”, një serie “inspektimesh të avionit dhe personelit”, një mohim i hyrjes për “inspektim të avionit dhe personelit”, konsultimi apo ndryshe, veprimi i menjëhershëm është thelbësor për sigurinë e një operimi të një shoqërie ajrore.
- 7) Çfarëdo veprimi nga njëra prej Palëve Kontraktuese në përputhje me paragrafët 2 ose 6 më lart të këtij neni do të ndërpritet kur arsyeja për marrjen e këtij veprimi pushon së ekzistuari.
- 8) Certifikatat apo gatishmëria për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara apo të bëra të vlefshme nga njëra Palë Kontraktuese, dhe ende në fuqi, njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese për qëllim të operimit të shërbimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që kërkesat sipas të cilave certifikata apo licenca të tilla janë lëshuar apo bërë të vlefshme, të jenë të njëjta apo më larta se standardet minimale që janë caktuar apo mund të përcaktohen në përputhje me Konventën. Megjithatë, secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën për të refuzuar që të njohë për qëllim të fluturimeve mbi territorin e saj, certifikata të kompetencës apo licencime të dhëna shtetasve të saj apo të bëra të vlefshme për ta nga ana e Palës tjetër Kontraktuese apo nga çdo shtet tjetër.
- 9) Nëse privilegjet apo kushtet e licencave apo certifikatave të përmendura në paragrafin 8 të mësipërm të këtij neni të lëshuara nga Autoritetet Aeronautike të një prej Palëve Kontraktuese për çdo person apo shoqëri ose shoqërite ajrore të caktuar(a) apo për sa i përket një avioni që operon shërbimet e rëna dakord në itineraret e specifikuar, do të lejonte një ndryshim nga standardet e përcaktuara në Konventë dhe një ndryshim i cili është depozituar në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacion Civil, Autoritetet e Aeronautikës të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime në pajtim me Nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje me Autoritetet Aeronautike të asaj Pale Kontraktuese, me qëllim bindjen e tyre se praktika në fjalë është e pranueshme për ta. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme do të përbëjë shkak për zbatimin e Nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15 SIGURIA E AVIACIONIT

- 1) Palët Kontraktuese ripohojnë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, se detyrimet e tyre ndaj njëri tjetrit për mbrojtjen e sigurisë së aviacionit civil kundër akteve të ndërhyrjes së paligjshme formojnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje. Pa kufizuar përgjithësimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, Palët Kontraktuese veprojnë veçanërisht në përputhje me dispozitat e Konventës për Veprat Penale dhe Akte të Tjera të Caktuara të Kryera në Bordin e një Avioni, nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963, Konventa për Shtypjen e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionëve të nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970, Konventa për Shtypjen e Veprimeve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Aviacionit Civil të nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971, Protokolli i saj shtesë për Shtypjen e Veprimeve të Paligjshme në Aeroporte që i Shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar të nënshkruar në Montreal më 24 shkurt 1988, Konventës për Shënjimin e Lëndëve Eksplozive Plastike për Qëllimin e Zbulimit, të nënshkruar në Montreal më 1 mars

1991 dhe çdo konventë të tjetër për sigurinë e aviacionit në të cilën Palët Kontraktuese bëhen palë.

- 2) Në bazë të një kërkesë, Palët Kontraktuese i paraqesin njëri tjetrit të gjithë ndihmën e nevojshme për të parandaluar veprime të konfiskimit të paligjshëm të avionëve civilë dhe veprime të paligjshme kundër sigurisë së avionëve të tillë, dhe pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, aeroportëve dhe ambienteve të tyre të navigimit ajror dhe çdo rrezik tjetër ndaj sigurisë së aviacionit civil.
- 3) Në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella Palët Kontraktuese veprojnë në pajtim me standardet e sigurisë së aviacionit dhe për sa kohë që zbatohen nga ato, praktikatat e rekomanduara të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil dhe të caktuara si Shtojca në Konventë; dhe kërkojnë që operuesit e avionëve të regjistrit të tyre, operatorët që kanë selinë e tyre qendrore të aktivitetit tregtar apo qëndrimin e përhershëm në territorin e tyre, dhe operuesit e aeroportëve në territorin e tyre, të veprojnë në pajtim me këto dispozita për sigurinë e aviacionit. Secila Palë Kontraktuese keshillon Palen tjetër Kontraktuese për çdo ndryshim ndërmjet rregullave të saj kombëtare dhe praktikave dhe standarteve të sigurisë së aviacionit të vendosura nga Konventa. Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime me Palen tjetër Kontraktuese në çdo kohë për të diskutuar çdo ndryshim të tillë. Në këtë paragraf referimi tek Standardet e Sigurisë së Aviacionit përfshin çdo ndryshim të njoftuar nga Palët Kontraktuese në fjalë.
- 4) Secila Palë Kontraktuese garanton se brenda territorit të saj janë marra masa efektive për mbrojtjen e avionit, kontrollin e pasagjerëve dhe sendet që ata marrin me vete, dhe për kryerjen e kontroleve të përshtatshme në ekuipazh, ngarkesë (përfshirë bagazhet e dorës) dhe depot e avionit përpara hipjes në avion dhe gjatë hipjes apo ngarkimit dhe se këto masa do të përshtaten për t'iu përgjigjur rritjes së rrezikut. Secila Palë Kontraktuese bie dakord që shoqërisë/ve të e saj të caktuar(a) mund t'u kërkojë të respektojnë dispozitat e sigurisë së aviacionit të përmendura në paragrafin (3), të kërkuara nga Pala tjetër Kontraktuese për hyrjen, largimin apo gjatë kohës së qëndrimit në territorin e asaj Palë tjetër Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese duhet gjithashtu të veprojë në mënyrë të favorshme me çdo kërkesë nga Pala tjetër Kontraktuese për masa të veçanta sigurie të arsyeshme për të përmbushur nevojat në lidhje me një rrezik të caktuar.
- 5) Kur ndodh një incident apo rrezik për incident për konfiskim të paligjshëm të avionit civil kundër sigurisë së këtij avioni, pasagjerëve të tyre apo ekuipazhit, aeroportëve apo agjentëve të navigimit ajror, Palët Kontraktuese ndihmojnë njëra tjetrën duke lehtësuar komunikimin dhe masa të tjera të përshtatshme që synojnë t'i japin fund sa më shpejt të jete e mundur këtij incidenti apo rreziku, në përputhje me një rrezik minimal për jetën.
- 6) Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtë, në rast se shoqëria ose shoqëritë ajrore e/te caktuar(a) e një Palë Kontraktuese fillon operacionet e shërbimeve të rena dakord në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas njoftimit (ose periudhës më të shkurtër, siç mund të bihet dakord ndërmjet Autoriteteve Aeronautike), për Autoritetet Aeronautike të saj të kryej një vlerësim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të masave të sigurisë që po kryhen, ose të planifikuara për t'u kryer, nga operatorët avionëve në lidhje me fluturimet që vijnë nga, ose nisen në territorin e Palës Kontraktuese të parë. Marrëveshjet administrative për kryerjen e vlerësimeve të tilla do të përcaktohen reciprokisht nga Autoritetet



Aeronautike dhe zbatohen pa vonesë në mënyrë që të sigurohet që vlerësimet do të zhvillohen shpejt.

- 7) Secila Palë Kontraktuese do të marrë masa të tilla, si ajo mund ta gjej të mundur, për të siguruar që një avion subjekt i një akti të konfiskimit të paligjshëm apo akteve të tjera të ndërhyrjeve të paligjshme që është ulur në territorin e saj të mbahet në tokë vetëm nëse largimi i tij nevojitet nga detyra mbizotëruese për të mbrojtur jetën njerëzore. Kudoqoftë e mundur, këto masa do të merren në bazë të konsultimeve të ndërsjella.
- 8) Kur një Palë Kontraktuese ka baza të arsyeshme për të besuar se Pala tjetër Kontraktuese ka larguar nga dispozitat e këtij neni, Pala e parë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime të menjëhershme. Konsultime të tilla do të fillojnë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e një kërkesë të tillë nga secila Palë Kontraktuese. Mosarritja e një marrëveshje të pranueshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e fillimit të konsultimeve, ose periudhë tjetër, siç mund të bihet dakord ndërmjet Palëve Kontraktuese, do të përbëjë shkak për tërheqjen, revokimin, pezullimin ose vendosjen e kushteve mbi autorizimet e shoqërisë ose shoqërive ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër Kontraktuese. Kur justifikohet nga një emergjencë, ose për të shmangur mospërputhjen e metejshme me dispozitat e këtij neni, Pala e parë Kontraktuese mund të marrë masa të përkohshme në çdo kohë. Çdo veprim i ndërmarrë në përputhje me këtë paragraf, do të ndërpritet me përmbushjen nga Pala tjetër Kontraktuese të dispozitave të sigurisë të këtij neni.

Neni 16

KONSULTIME DHE MODIFIKIME

- 1) Shkëmbimi i pikëpamjeve kryhet sipas nevojës ndërmjet Autoriteteve Aeronautike të Palëve Kontraktuese për të arritur bashkëpunim më të ngushtë dhe marrëveshje për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 2) Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë në çdo kohë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese, me qëllim ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje apo Shtojcës së saj. Këto konsultime fillojnë brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së një kërkesë të tillë. Çfarëdo ndryshimi në këtë Marrëveshje të rënë dakord si rezultat i këtyre konsultimeve do të miratohet nga secila Palë Kontraktuese, në përputhje me procedurat e saj kushtetuese dhe do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të notave diplomatike që tregojnë këtë miratim.
- 3) Nëse ndryshimi ka lidhje vetëm me Shtojcën, konsultimet duhet të jenë ndërmjet Autoriteteve Aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Kur autoritetet bien dakord për një Shtojcë të re apo të rishikuar, ndryshimi për të cilin është rënë dakord do të hyjë në fuqi sapo të konfirmohen nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike.

Neni 17
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 1) Nëse ndërmjet Palëve Kontraktuese lind ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese duhet fillimisht të përpiqen ta zgjidhin nëpërmjet bisedimeve ndërmjet njëri tjetrit.
- 2) Nëse Palët Kontraktuese nuk arrijnë një zgjidhje me bisedime brenda gjashtedhjetë (60) ditëve, ato e referojnë mosmarrëveshjen tek një person apo organ apo me kërkesë të një prej Palëve Kontraktuese, tek një gjykatë arbitrazhi.

Gjykata e arbitrazhit përbëhet si më poshtë:

- a) Çdo Palë Kontraktuese emëron një arbitër; nëse njëra Palë Kontraktuese nuk emëron arbitrin e saj brenda gjashtedhjetë (60) ditëve, ky arbitër emërohet nga Presidenti i Këshillit të Organizatës së Aviacionit Civil, me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese.
- b) Arbitri i tretë i cili duhet të jetë shtetas i një shteti të tretë dhe që duhet të kryesojë gjykatën e arbitrazhit, emërohet ose
 1. me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese; ose
 2. nëse brenda gjashtedhjetë (60) ditësh Palët Kontraktuese nuk bien dakord, me emërimin nga Kryetari i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil me kërkesë të secilës Palë Kontraktuese. Nëse Kryetari është me të njëjtën shtetësi si ajo e një prej Palëve Kontraktuese, Zëvendëskryetari më të vjetër i cili nuk është skualifikuar mbi këto baza bën emërimin.
- 3) Gjykata e arbitrazhit e merr vendimin e saj me shumicë votash. Ky vendim është i detyrueshëm për të dyja Palët Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese duhet të mbulojë shpenzimet e anëtarëve të saj, si dhe të përfaqësimit të saj në procedurën e arbitrazhit; Shpenzimet për kryetarin dhe çdo shpenzim tjetër do të mbulohen në pjesë të barabarta nga Palët Kontraktuese. Për sa i përket të gjitha aspekteve të tjera, gjykata e arbitrazhit përcakton procedurën vet.
- 4) Gjykata e Arbitrazhit përpiqet të japë një vendim me shkrim brenda gjashtedhjetë (60) ditëve pas përfundimit të seancës ose, nëse nuk zhvillohet seancë, brenda gjashtedhjetë (60) ditëve pas datës së paraqitjes së dy përgjigjeve.
- 5) Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është përfundimtar dhe detyrues për Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje.
- 6) Nëse dhe për sa kohë një Palë Kontraktuese nuk respekton vendimin e dhënë sipas paragrafit 5 të këtij Neni, Pala tjetër Kontraktuese mund të kufizojë, pezullojë ose revokojë çdo të drejtë ose privilegj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 18
PËRFUNDIMI

Secila Palë Kontraktuese mund të njoftojë në çdo kohë me shkrim Palën tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje. Një kopje e njoftimit duhet të dërgohet njëkohësisht tek Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Nëse ky njoftim është dhënë, kjo Marrëveshje do të përfundojë dymbëdhjetë



(12) muaj pas datës së marrjes nga Pala tjetër Kontraktuese të njoftimit për përfundimin, përveç nëse me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, njoftimi në fjalë tërhiqet përpara kalimit të këtij afati. Nëse Pala tjetër Kontraktuese nuk konfirmon marrjen, njoftimi do të konsiderohet se është marrë katërmëdhjetë (14) ditë pas datës së marrjes së kopjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Neni 19

PAJTUESHMËRIA ME KONVENTAT SHUMËPALËSHE

Në rastin e hyrjes në fuqi të një konvente të përgjithshme shumëpalëshe për transportin ajror të pranuar nga Palët Kontraktuese, dispozitat e kësaj konvente do të kenë përparësi. Çdo diskutim me qëllim përcaktimin e shkallës në të cilën kjo Marrëveshje përfundon, zëvendësohet, ndryshohet ose plotësohet nga dispozitat e konventës shumëpalëshe, do të kryhet në përputhje me paragrafin (2) të Nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20

REGJISTRIMI

Kjo Marrëveshje regjistrohet pranë Organizatës Ndërkombëtare për Aviacionin Civil, nga shteti ku do të nënshkruhet Marrëveshja.

Neni 21

TITUJT

Titujt janë vendosur në këtë Marrëveshje në krye të çdo neni për qëllim referimi dhe lehtësie dhe në asnjë mënyrë nuk përcaktojnë, kufizojnë apo përshkruajnë objektin apo qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përmbushjes të kërkesave të brendshme ligjore nga secila Palë Kontaktuese, të cilat njoftojnë njëra tjetrën për përmbushjen e kërkesave të tilla nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës nga data e marrjes së njoftimit të fundit

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje

Bërë në _____ më _____, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike. Megjithatë, në rast mospërputhjesh për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje apo Shtojcës së saj, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë**

**Për Qeverinë
e Shtetit të Kuvajtit**

SHTOJCË

Seksioni 1:

Rrugët që do të operohen nga shoqëritë ajrore të caktuara të shtetit të Kuvajtit në dyja drejtimet.

Pikat e origjinës	Pikat e ndërmjetme	Pikat e destinacionit	Pika e përfundimtare
Pika në shtetin e Kuvajtit	Çfarëdo pike	Pika në Republikën e Shqipërisë	Çfarëdo pike

Seksioni 2:

Rrugët që do të operohen nga shoqëritë ajrore të caktuara të Republikës së Shqipërisë në të dyja drejtimet:

Pikat e origjinës	Pikat e ndërmjetme	Pikat e destinacionit	Pika e përfundimtare
Pika në Republikën e Shqipërisë	Çfarëdo pike	Pika në Shtetin e Kuvajtit	Çfarëdo pike

Shënime:

- (i) Pikat e ndërmjetme dhe pikat e përfundimtare, sipas zgjedhjes së shoqërisë ajrore të caktuar, mund të lihen jashtë për një apo të gjitha fluturimet, me kusht që shërbimet e rëna dakord në këto rrugë të fillojnë dhe përfundojnë në një pikë në territorin e Palës Kontraktuese që përcakton shoqërinë ajrore.
- (ii) Shoqëritë ajrore të caktuara të secilës Palë Kontraktuese, për ndonjërin apo të gjitha fluturimet, mund të ushtrojnë të drejtën e pestë të lirisë së trafikut në çdo pikë të ndërmjetme dhe/ose të përfundimtare

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 19.4.2013
Doli nga shtypi më 19.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 50 lekë